



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Masteri i Shkencave në
Administrim i Shërbimeve Sociale”**

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i Tiranës”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof Dr. Osman Metalla
2. Dr. Jordan Jorgji

Qershor/2025

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Master i Shkencave në “Administrim i Shërbimeve Sociale”
ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i Tiranës”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Administrim i Shërbimeve Sociale”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASh Nr. 512, datë 14.10.2011, ndryshuar me UMAS Nr. 212, datë 02.06.2015
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 247, datë 17.11.2023.
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli II
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 Vite / 4 Semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	14 PAE / 7 PAK v.a. 2022-2023 13 PAE / 7 PAK v.a. 2023-2024
18	Numri i studentëve:	39 Studentë v.a. 2022-2023 31 Studentë v.a. 2023-2024
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi Master Shkencor në “Administrim i Shërbimeve Sociale” ofrohet nga Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale, FSHS/UT, si pjesë e ciklit të dytë të studimeve. Ky program u hap me Urdhërin nr. 513, datë 14.10.2011, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, në përputhje me nevojat e reja akademike dhe profesionale, me synimin për të zgjeruar dhe plotësuar studimet e ciklit të parë për studentët e degëve të administrimit dhe politikës sociale, punës sociale dhe fushave të tjera të ngjashme. Hapja e këtij masteri përfaqëson një përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës, duke pajisur studentët me diplomë dhe dokumente të lëshuara nga Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale, një strukturë me histori 32-vjeçare që daton nga viti 1992 në Tiranë.

Njësia përgjegjëse për këtë program është Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale në Universitetin e Tiranës. Programi i studimit “Master i Shkencave” në “Administrim i Shërbimeve Sociale” i përket nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Ai është ndërtuar në përputhje me Marrëveshjen e Bolonjës dhe synon të formësojë administratorët e ardhshëm të shërbimeve sociale, të cilët do të luajnë një rol kyç në planifikimin, koordinimin dhe zbatimin e iniciativave për mbështetjen e individëve dhe komuniteteve në nevojë. Përtej rolit administrativ, ky program synon të përgatisë profesionistë të angazhuar ndaj drejtësisë sociale dhe të drejtave të njeriut, të cilët do të jenë të përditësuar me tendencat sociale dhe praktikat më të mira në këtë fushë.

Programi bazohet në parimet e lirisë akademike, autonomisë institucionale, cilësisë dhe vetëfinancimit, duke garantuar mundësi të barabarta për të gjithë kandidatët që plotësojnë kriteret e pranimit. Ai integron mësimdhënien me kërkimin shkencor dhe ofron një mjedis akademik ku stafi me tituj dhe grada shkencore bashkëpunon ngushtë me studentët për të ofruar një përvojë të pasur akademike dhe profesionale.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm u bazua në tre hapa kryesorë. Së pari, ekspertët e vlerësimit të jashtëm u njohën me dokumentacionin bashkangjitur në platformën elektronike (E-ASCAL), konkretisht me Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) dhe me të gjitha evidencat shoqëruese. Së dyti, në koordinim me përfaqësuesin e ASCAL-it ekspertët ndërmorrën vizita dy-ditore në institucion (në datat 28-29 janar 2025), sipas agjendës së përcaktuar nga ASCAL-i. Gjatë këtyre vizitave, të dhënat e RVB-së u kryqëzuan përmes diskutimeve me stafin akademik dhe autoritetet përkatëse. Së treti, ekspertët vijuan me hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) në koordinim me njëri-tjetrin. Gjatë hartimit ekspertët patën biseda të shpeshta ku diskutuan korrespondimin e pjesëve të ndryshme të raportit me evidencat e vënë në dispozicion. Gjithashtu, ata rakorduan punën për harmonizimin e pjesëve të raportit me qëllim shmangien e përsëritjeve dhe dhënies së theksit ndaj pikave të dobëta dhe të forta të programit të studimit. Hartimi u përmbyll brenda periudhës së përcaktuar nga realizimi i vizitave dhe iu dërgua përfaqësuesit të ASCAL-it. Bashkëpunimi ndërmjet ekspertëve dhe me përfaqësuesin e ASCAL-it ishte tepër pozitiv.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Shkencor në “Administrim i Shërbimeve Sociale”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1

Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti i Tiranës (UT) është Institucion publik i Arsimit të Lartë i cili rregullon veprimtarinë e tij në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë. Programet e studimit që ofron UT i përmbahen Ligjit 80/2015 të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, përfshirë edhe normat juridike-administrative të këtij universiteti, si Statuti, Rregullorja dhe dokumentet e njësive më të decentralizuara (rregullorja e njësive kryesore dhe asaj bazë). Si i tillë, UT ofron programe studime që nuk bien ndesh me interesat kombëtare. Gjithashtu, falë përvojës së gjatë në mësimdhënie dhe në kërkim shkencor të UT, synohet ruajtja dhe konsolidimi i vlerave kombëtare dhe atyre akademike. UT dhe njësitet akademike përbërëse të tij ofrojnë programe studimi sipas niveleve 6-8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, sipas ligjit nr.10 247, dt. 4.3.2010. Evidenca: 1.2. Statuti i UT <https://unitir.edu.al/ep-content/uploads/2019/08/Statuti_2018.pdf> 1.3. Rregullore e UT <https://unitir.edu.al/rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022/> 1.4. Strategjia e UT <https://unitir.edu.al/strategjia-e-zhvillimit-te-universitetit-te-tiranes-per-periudhen-2023-2028/> -- Korniza Shqiptare të Kualifikimeve, sipas ligjit nr.10 247, dt. 04/03/2010, <https://qsha.gov.al/ep-content/uploads/2023/08/ligj_10247-2010_04032010.pdf> (nuk citohet në dokumentacion).
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe	Programi i studimit Master Shkencor në Administrim të Shërbimeve Sociale është hartuar në përputhje me qëllimet, misionin dhe vizionin e UT, i cili është zhvillimi i shoqërisë përmes

misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	edukimit, kërkimit shkencor dhe shërbimit ndaj publikut. Paralelisht, hartimi i programit të studimit në nivelin e 7-të të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve është në përputhje me kuadrin ligjor për arsimin e lartë për sa i përket fushës së veprimtarisë së shkencave sociale, dhe më konkretisht ofrimit dhe administrimit të shërbimeve sociale. Evidenca: 3.3.1. Të dhëna Tabelore për numrin e programenve në ciklin e I -rë, të II - të dhe të III -të të studimeve që ofrohen në Njësinë përgjegjëse 4.1. Korniza konceptuale e programit të studimit -- Misioni dhe vizioni i UT <https://unitir.edu.al/vizioni-dhe-misioni/> (nuk citohet në dokumentacion).
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike të Institucionit.	Programi i studimit funksionon në përputhje me strategjinë institucionale për mësimdhënien (objektivat 1 deri 7), me Statutin dhe me rregulloren e UT, si dhe me objektivat e Strategjisë së Zhvillimit të fakultetit ku ky program studimi bën pjesë. Administrimi i Shërbimeve Sociale është një nga fushat akademike që mbulon Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale dhe Fakulteti i Shkencave Sociale (FSHS). Kjo përputhshmëri me drejtimet akademike të njëjve në fjalë, pjesë e UT, plotësohet nga harmonia e programit të studimit me qëllimet dhe objektivat e Strategjisë për zhvillimin e departamentit dhe me drejtimet strategjike të Strategjisë për zhvillimin e programit të studimit. Evidenca: 1.2. Statuti i UT <https://unitir.edu.al/ep-content/uploads/2019/08/Statuti_2018.pdf> 1.24. Strategjia institucionale per mesimdhënien 2022-2027 1.3. Rregullore e UT <https://unitir.edu.al/rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022/> 2.3. Strategjia e Zhvillimit e Fakultetit të Shkencave Sociale 3.2. Strategjia e zhvillimit të Departamentit 3.5. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit Master Shkencor në 'Administrim i Shërbimeve Sociale' 2020 - 2024 3.6. Rregullore e programit të studimit Master Shkencor ' Administrim i Shërbimeve Sociale
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet	Falë cilësisë dhe integritetit të stafit akademik të angazhuar në programin e studimit, transparencës dhe përditësimit të kurrikulës, si dhe bashkëpunimit me universitete prestigjioze në vendet e Bashkimit Evropian, programi i studimit është në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026 për sa i përket




globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.

shërbimit të interesit kombëtar dhe ndërkombëtarizimit. Programi i studimit përcjell misionin e UT për kultivimin e dijes dhe të cilësive morale-shoqërore, për përgatitjen e profesionistëve që administrojnë shërbimet sociale, të motivuar për të punuar në rajone të ndryshme të Shqipërisë në përputhje me kërkesat e tregut të punës, si dhe për kultivimin e mendimit kritik dhe produktiv. Hartimi dhe përditësimi i programit është gjithashtu në kohezion me Strategjinë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017-2022, me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, Strategjinë Kombëtare e Punësimit dhe e Aftësive, si dhe me Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030.

Departamenti organizon konferenca të përvitshme shkencore në fushën e punës sociale dhe të politikave sociale, në bashkëpunim me universitete partnere në Shqipëri, si Shkodra dhe Elbasani, ku rrahen problematikat kryesore në nivel kombëtar. Në përmirësimin e kurrikulës së programit të studimit me trendet globale të politikave sociale dhe administrimit të shërbimeve sociale, departamenti shrytëzon bashkëpunimet që ka me partnerë socialë, brenda dhe jashtë Shqipërisë, ashtu si dhe përvojën e stafit akademik në mobilitete dhe projekte ndërkombëtare. Një lëndë e tillë që pasqyron prirjet aktuale ndërkombëtare në përditësimet kurrikulare është *Teoritë dhe Zhvillimet e Reja Sociale*. Nëse shihet e arsyeshme departamenti mund të shtojë lëndë në të ardhmen që pasyrojnë prirjet kryesore në vendet e BE dhe OECD.

Evidenca:

3.24. Dosje e leksioneve, aktiviteteve, konferencave të hapura

4.2.1. Plani mësimor sipas modelit të Tabelës

4.7. Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit

--Strategjia kombëtare për arsimin 2021-2026,

<<https://arsimi.gov.al/ep-content/uploads/2021/05/Draft-Strategjia-per-Arsimin-2021-2026.pdf>>

--Strategjia Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017-2022, <https://arsimi.gov.al/ep-content/uploads/2019/07/Vendim-i-KM_710_01.12.2017_Strategjia-e-Kerkimit-Shkencor.pdf>

--Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, <<https://ëëë.kryeministria.al/strategjia-kombetare-per-zhvillim-dhe-integrim-2015-2020/>>

--Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe e Aftësive.

<<https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/561>>

	--Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, < https://shendetesia.gov.al/ep-content/uploads/2022/02/ËEB_Strategjia-Kombetare-AL.pdf >			
Konkluzione	Pjesë e UT, programi i studimit Master shkencor në Administrim i Shërbimeve Sociale është hartuar dhe funksionon në përputhje me misionin dhe qëllimin e UT për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, dhe në një kontekst më të gjerë ai ruan dhe përcjell interesat dhe vlerat e përgjithshme sipas strategjive kombëtare, përfshirë edhe prirjet e aktorëve prestigjiozë ndërkombëtarë. Programi funksionon në përputhje me statutin dhe rregulloren e UT, si dhe dokumentacionin përkatës të njësisë kryesore dhe asaj bazë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	UT dhe FSHS kanë në organikën e vet një staf të kualifikuar akademik, që ndërthur njohuritë akademike me ekspertizën e pasur në fushat specifike. Një pjesë e rëndësishme e stafit të programit të studimit është e kategorisë Profesor (1 prof.dr. dhe 8 prof.as. dr.) ndërsa Personeli Akademik me Kontratë (PAK) ka përvojë bashkëpunimi me aktorë të rëndësishëm të shoqërisë, si Institutin Shqiptar të Integritimit Social, Presidencën, Inspektoriatin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore dhe organizata joqeveritare. Gjithashtu, departamenti siguron bashkëpunim me institucione të rëndësishme shoqërore dhe sociale falë marrëveshjeve për realizimin e praktikave profesionale të studentëve, por edhe marrëveshjeve të bashkëpunimit që ka firmosur njësia kryesore dhe UT si IAL. Evidenca: 1.10.1. Marrëveshje bashkëpunimi midis Albanian-American development foundation 3.19. Raport periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshja e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit. 3.21. Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese për programin e studimit dhe për Praktikën profesionale 4.7. Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423


Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi i studimit Master shkencor në Administrimin e Shërbimeve Sociale realizohet për një periudhë 2-vjeçare, me kohë të plotë dhe me 120 kredite ECTS. Ai ofron studime të thelluara në fushën e administrimit të politikave sociale. Fusha e përgjithshme e programit të studimit (shkencat sociale) dhe ajo specifike (administrimi i politikave dhe shërbimeve sociale) janë në përputhje me Fakultetin e Shkencave Sociale (FSHS) brenda së cilës operon ky program studimi. Kjo i referohet Udhëzimit Nr. 31 dt. 15/11/2022 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për kodifikimin e programeve të studimit, të cilat citojnë Standardin Ndërkombëtar të Klasifikimit në Edukim (ISCED 2011), ku programi në fjalë është brenda kategorisë 3 të Shkencave Sociale, biznesit dhe ligjit, dhe nënkategorisë 3.1. Shkencat sociale dhe ato të sjelljes. Evidenca: 2.3. <i>Strategjia e Zhvillimit e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023-2028</i> 3.2. <i>Strategjia e zhvillimit të Departamentit</i> 3.5. <i>Strategjia e zhvillimit të programit të studimit Master Shkencor në 'Administrim i Shërbimeve Sociale' 2020 - 2024</i> -- Udhëzim nr 31 dt. 15/11/2022, <https://arsimi.gov.al/ep-content/uploads/2022/11/Udhezim-Nr.31-date-15.11.2022-Kodifikimi-i-programeve-te-studimit-IAL-pdf.pdf> -- Vendim nr. 310 dt. 11/05/2022 për Specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit, <https://arsimi.gov.al/ep-content/uploads/2023/12/vendim-310-date-11.05.2022.pdf> -- International Standard Classification of Education ISCED 2011, <https://uis.unesco.org/sites/default/files/documents/international-standard-classification-of-education-isced-2011-en.pdf>
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Në ngjashmëri me kriterin e mësipërm (kriterin 2), programi i studimit Master shkencor në Administrimin e Shërbimeve Sociale është në përputhje me fushën akademike e kërkimore-shkencore të Departamentit të Punës dhe Politikave Sociale (DPPS). Për sa i përket drejtimit të programit të studimit, ky i fundit mbulohet nga departamenti në fjalë dhe nuk ka karakter ndërdepartamentar. Megjithatë, duke patur parasysh karakterin ndërdisiplinor të programit, Administrim nga njëra anë dhe shërbime sociale nga ana tjetër, <i>mund të kërkohet një bashkëpunim më i madh me Fakultetin Ekonomik për sa i përket përditësimit të kurrikulës dhe ekspertizës specifike në pjesën ekonomike të administrimit të shërbimeve. Kjo mund të merret si një rekomandim për të ardhmen e programit të studimit.</i>



	Evidencat: -- Sipas kriterit të mësipërm 3.6. Rregullore e programit të studimit Master Shkencor ' Administrim i Shërbimeve Sociale 4.7. Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit 5.5. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	Nuk aplikohet.
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	UT ofron mundësi për trajnimin profesional të mëtjshëm për studentët e diplomuar (alumni), siç duket në tabelën përmbledhëse me trajnime. Në FSHS funksionon shërbimi i karrierës i cili ofron shërbime informimi, këshillimi dhe trajnimi për studentët dhe ata të diplomuar. Mbajtja e kontakteve me këta të fundit realizohet në mënyrë elektronike përmes një linku të veçantë. Nga gjurmimi i fundit në nivel fakulteti rezulton se ka një shkallë të lartë punësimi të studentëve të diplomuar. Gjithashtu, studentët marrin pjesë në panairët e punës ndërkohë që nëse ata kanë kërkesa mund të ndihmohen për t'u trajnuar nga një pjesë e pedagogëve të jashtëm (PAK) që vijnë nga institucionet me të cilat bashkëpunon departamenti. Departamenti mban kontakte të rregullta me studentët e diplomuar, të cilët ftohen në veprimtari relevante që organizon departamenti, siç janë konferencat periodike ku diskutohen problematikat aktuale në fushën e punës sociale dhe administrimit të shërbimeve sociale. <i>Megjithatë, produkti i kontakteve me studentët alumni mund të operacionalizohet më mirë me anën e tryezave të rrumbullakëta ku të diskutohen problematikat e ndryshme në lidhje me eficiencën e kurrikulës së programit dhe sfidave të studentëve kur këta të fundit dalin në tregun e punës. Duke qenë se FSHS disponon një staf të kualifikuar akademik dhe thith profesionistë nga institucionet partnere, fakulteti ka mundësi që të organizojë në të ardhmen panairë pune posaçërisht në fushën e shkencave sociale.</i>



	Evidenca: 3.21.1 Tabelë përmbledhëse me trajnime, konkurse, praktika profesionale, intership dhe mundësi punësimi për studentër e diplomuar 3.30. Studim i tregut në lidhje me statusin e punësimit të studentëve dhe të të diplomuarve -- Linku i përdorur për mbledhjen e të dhënave < https://forms.office.com/r/P4uvëBvEqg > -- Shëbimi i karrierës në FSHS < https://fshs-ut.edu.al/rreth-fakultetit/sherbimi-i-karrieres > -- Zyra e karrierës në UT < https://unitir.edu.al/marredheniet-me-studentet-dhe-karriera/ >			
Konkluzione	Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion. Staf i angazhuar ka përvojë të konsiderueshme në njohurit akademike dhe në ekspertizën profesionale. Rekomandohet shfrytëzimi i mëtejshëm i karakterit ndërdisiplinar të programit të studimit dhe forcimi i mëtejshëm kontakteve me studentët e diplomuar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	DPPS e realizon mbarëvajtjen e programit të studimit në respekt të rregulloreve të departamentit, të fakultetit (FSHS) dhe të universitetit (UT) përfshirë edhe Statutin e UT. Nëpërmjet këtyre normave dhe në bazë të Ligjit Nr. 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, të cilin e reflektojnë normat e përmendura (Statuti dhe rregulloret), puna veprimi shtrihet tek stafi akademik i angazhuar në programin e studimit si dhe në hallkat e tjera ndihmuese, si personeli administrativ dhe studentët. Në këtë mënyrë DPPS ndan detyrat për funksionimin e programit të studimit dhe përmbushjen e nevojave të ndryshme relevante. Mbarëvajtja realizohet përmes një ndarje vertikale të strukturuar mes njësisë kryesore dhe njësisë bazë, ku përfshihet edhe caktimi i një koordinatori përgjegjës për programin e studimit. Në bazë të Rregullores së programit të studimit (nenet 11-13) koordinatori

	mbikqyr funksionimin e programit të studimit dhe së bashku me përgjegjësin e njësisë bazë siguron mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe të nevojave relevante. Evidencat: 1.2. Statuti i UT <https://unitir.edu.al/ep-content/uploads/2019/08/Statuti_2018.pdf> 1.3. Rregullore e UT <https://unitir.edu.al/rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022/> 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023 3.11. Vendim për caktimin e koordinatorit të programeve të studimit të vitit 2017 3.3. Rregullore e Departamentit të Punës dhe Politikës Sociale 3.6. Rregullore e programit të studimit Master Shkencor 'Administrim i Shërbimeve Sociale'
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Për realizimin e objektivave të programit të studimit, DPPS shfrytëzon marrëdhëniet e bashkëpunimit që ai si departament por edhe FSHS së bashku me UT kanë vendosur me institucione partnere dhe me aktorë të shoqërisë të biznesit. Gjithashtu, DPPS ka një sfond të pasur bashkëpunimi me universitete prestigjioze evropiane, të cituara në raportin analitik të përfitimeve. Evidenca: 3.19. Raport periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshja e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit. 3.21. Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese për programin e studimit dhe për Praktikën profesionale. 3.21.1 Tabelë përmbledhëse me trajnime, konkurse, praktika profesionale, intership dhe mundësi punësimi për studentër e diplomuar.
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e	Në vijim të kriterit të mësipërm (kriterin 2), DPPS operacionalizohen kryesisht në praktikat profesionale që studentët kryejnë pranë këtyre institucioneve partnere. Departamenti dhe fakulteti ruajnë një gamë të gjerë bashkëpunimi me institucione lokale që lidhen me sektorin e politikave publike (Bashkia e Tiranës) dhe më konkretisht me institucionet të cilat lidhen me sektorin e shërbimeve sociale. Gjatë kryerjes së praktikës profesionale zbatohet manuali i praktikës, plotësohet ditari i praktikës dhe hartohet një ese e veçantë, të cilat shërbejnë për vlerësimin e studentit. Nga takimi me studentët rezultoi një impakt pozitiv për institucionin e Drejtorisë së Burgjeve, ku praktika profesionale lidhet më ngushtë me fushën e studimit të programit të studimit. Rekomandohet që departamenti

praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	<i>të aplikojë një shpërndarje dhe orientim më të organizuar të institucionit të praktikës profesionale, me qëllim lehtësimin e studentit.</i> Është e kuptueshme që për vet natyrën e programit të studimit Master Shkencor, një pjesë e studentëve gjenden në marrëdhënie pune, dhe në këtë kontekst ata mund t'a shfrytëzojnë institucionin relevant me fushën e studimit për kryerjen e praktikës institucionale. <i>Megjithatë, një shpërndarje e organizuar e praktikës do të shmangte vështirësinë e studentit për të gjetur institucion në një metropol si Tirana ku përqendrohen një sërë institucionesh dhe aktorësh shoqërorë.</i> Evidenca: 3.19. Raport periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshja e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit. 3.21. Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese për programin e studimit dhe për Praktikën profesionale. 3.21.1 Tabelë përmbledhëse me trajnime, konkurse, praktika profesionale, intership dhe mundësi punësimi për studentër e diplomuar. 4.4 (1) Ditari i praktikës profesionale 4.4 (2) Kërkesë për esenë e praktikës 4.4 (3) Manual për praktikat e studentëve
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	DPPS mbikqyr eficiencën e praktikës profesionale dhe raporton në mënyrë periodike përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit. Problemet që dalin diskutohen në analizat periodike të departamentit dhe në raportet e NJSBC-së. Nga takimi me studentët dhe sektorin e karrierës dhe alumnit nuk rezultuan probleme të veçanta në lidhje me realizimin e praktikës profesionale. <i>Në kontekstin aplikativ rekomandohen kontakte të rregullta me institucionet e praktikës profesionale në formën e tryezave të rrumbullakëta, me qëllim operacionalizimin sa më eficient të mundësive që ofron praktika për thellimin e njohurive dhe punësimin e studentëve.</i> Evidenca: 2.16. Analizë vjetore e punës së Fakultetit të Shkencave Sociale 2021-2022, 2022-2023. 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024. 3.18 2022-2023 Raport vjetor i Departamentit i Punës dhe Politikës Sociale viti akademik 2022 – 2023. 3.18 Raport vjetor i DPPS 2023-2024.


	3.19. Raport periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshja e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit.			
Konkluzione	Në funksion të përmbushjes së programit të studimit, DPPS ka vendosur një gamë të pasur bashkëpunimi me institucione partnere, përfshirë edhe universitete prestigjioze evropiane. Një pjesë e marrëveshjeve të bashkëpunimit konkretizohen tek praktikat profesionale të studentëve. Rekomandohet shpërndarje më e orientuar e studentëve tek institucionet e praktikës profesionale dhe kontakte të përditësuara me ato institucione.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit është i organizuar dhe i strukturuar në kredite, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe në harmoni me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve. Plani mësimor aktual i programit të studimit është i përbërë nga A: Lëndët bazë (18 ECTS - 15%), B: Lëndët Karakterizuese (42 ECTS - 35%), C: Lëndët Ndërdisciplinore/Integruese (12 ECTS - 10%), E: Lëndët plotësuese (18 ECTS - 15%) dhe F: Detyrimet përmblëse (30 ECTS - 25%). Në përfundim të programit studenti grumbullon një total prej 120 kredite ECTS. <i>Megjithatë rezulton se lëndët e këtij programi studimi janë kategorizuar nga A në F dhe jo sipas VKM-së nr. 41 dt. 24/01/2018 nga A në E. Kjo u ngrit si problematikë edhe nga anëtarët e GVB-së gjatë vizitës në institucion.</i> Evidenca: 3.6. Rregullore e programit të studimit Master Shkencor 'Administrim i Shërbimeve Sociale'.

	4.2. 2022- 2023, 2023 - 2024 Plani i miratuar mësimor i programit të studimit.
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi i studimit është një gërshtetim i konceptit me karakter menaxherial dhe politik “administrim” me sektorin e politikave dhe të shërbimeve sociale. Si i tillë, ai synon të përgatisë profesionistë të mirëfilltë për administrim e shërbimeve sociale, në kontekstin e përgjithshëm të mirëfunksionimit të shtetit social. Ai është i hartuar i tillë dhe funksionon në mënyrë që të ndërthurë përvetësimin e njohurive teorike me aplikimin e tyre në terren, duke kultivuar paralelisht mendimin kritik. Karakter i ndërdisiplinor i programit të studimit e bën të nevojshëm koordinimin sistematik jo vetëm me palët e angazhuara, por akoma më tej me ekspertët që përfaqësojnë institucione relevante me programin e studimit dhe si të tillë janë të përditësuar me problematikat e përditshme të shërbimeve sociale. <i>Vlerësoret se DPPS është i hapur në afrimin e tyre si PAK dhe rekomandohet një bashkëpunim më i thelluar me këtë kategori ekspertësh. Këta mund të ndihmojnë në përditësimin e kurrikulës, në shkathhtësimin e studentëve me tematikat e administrimit të shërbimeve sociale si një fushë studimi me karakter aplikativ, si dhe në orientimin e studentëve të diplomuar në sektorin relevant të punësimit.</i> Evidenca: 1.25. Plani strategjik i UT për zhvillimin e personelit akademik 2023-2028 VS-6-date-30.01.2023 3.2. Strategjia e zhvillimit të Departamentit 3.5. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit Master Shkencor në 'Administrim i Shërbimeve Sociale' 2020 - 2024 4.1. Korniza konceptuale e programit të studimit.
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Karakter i aplikativ i programit të studimit forcohet edhe nga rëndësia që DPPS i ka kushtuar praktikës profesionale në tre semestra me një total prej 18 kreditesh ETCS, si dhe detyrimeve përmbyllëse të temës së diplomës me 30 kredite ETCS. Të dyja këto i korrespondojnë 40% të ngarkesës së programit të studimit (15% praktika profesionale dhe 25% mikroteza). Evidenca: 2.11. Rregullore e Diplomimit FSHS. 4.2. 2022- 2023, 2023 - 2024 Plani i miratuar mësimor i programit të studimit. 4.2.1. Plani mësimor sipas modelit të Tabelës 10. 4.2.2 Plani Mesimor i ndare sipas veprimtarive AF.



Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	Nuk aplikohet.
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	Nuk aplikohet.
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Nuk aplikohet.



Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtësë, duhet	Nga kontrolli bërë nga GJV, rezulton se në Shqipëri nuk ka program studimi të ciklit të dytë Master shkencor që ofrohet në të njëjtën fushë studimi dhe me të njëjtën emërtësë.			
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi i studimit respekton procesin e kodifikimit sipas dokumenteve të cituara në evidencat e këtij kriteri. Evidenca: -- Udhëzimi i MAS nr. 31 dt. 15/11/2022 për procedurat e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga IAL në Republikën e Shqipërisë, <https://arsimi.gov.al/ep-content/uploads/2022/11/Udhezim-Nr.31-date-15.11.2022-Kodifikimi-i-programeve-te-studimit-IAL-pdf.pdf>. -- Vendim nr. 310 dt. 11/05/2022 për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga IAL në Republikën e Shqipërisë, <https://arsimi.gov.al/ep-content/uploads/2023/12/vendim-310-date-11.05.2022.pdf>.			
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Nuk aplikohet.			
Konkluzione	Programi i studimit ndërthur njohuritë teorike me aspektin aplikativ. Ai i kushton një vëmendje të veçantë praktikës profesionale dhe detyrime përmbyllëse, të cilat i korrespondojnë 40% të ngarkesës mësimore. Rekomandohet përditësimi i planit mësimor në respekt të VKM nr. 41 dt. 24/01/2018. Ky është edhe problem kryesor i këtij programi studimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2


Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	FSHS dhe DPPS organizojnë punën e tyre sipas normave në fuqi të UT dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar. Struktura akademike miratohet çdo vit nga Senati Akademik, në koordinim me njësitë kryesore dhe ato bazë, të cilat janë përgjegjëse për organizimin e veprimtarisë së tyre dhe stafit përkatës akademik. Vlerësimi dhe menaxhimi i cilësisë kryhet çdo vit nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në nivel FSHS. NJSBC bashkëpunon me DPPS për përmbushjen e veprimtarisë vlerësuese të programit të studimit. Ajo kryhen pyetësorë periodikë me studentë, ku pas përpunimit të të dhënave përfundimet i bëhen të ditura dekanit ose zv/dekanit si dhe përgjegjësve të departamenteve, me qëllim që këta të fundit t'i bëjnë objekt të analizave të tyre brenda departamentit dhe në nivel program studimi. NJSBC bashkëpunon me njësinë homologe në nivel rektorati si dhe me përfaqësuesit e ASCAL. Për sa i përket procesit të akreditimit të programeve të studimit, Departamenti cakton një grup pune (GVB) i cili harton Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) dhe organizon evidencat përkatëse në bashkëpunim me departamentin dhe me strukturat e tjera të UT. Evidenca: 1.2. Statuti i UT <https://unitir.edu.al/ep-content/uploads/2019/08/Statuti_2018.pdf> 1.6. Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT. 1.6.1. Rregullore për-organizmin-dhe-funksionimin-e-njesive-te-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise 2022. 2.12. Vendim i FSHS-së për ngritjen e Njesisë së Sigurimit të Cilësisë. 2.15. Të dhëna për NJSC (tabela 24) dhe GVB. 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	DPPS në koordinim me FSHS, angazhon personelin akademik efektiv (PAE) dhe personelin administrativ për realizimin e praktikës profesionale të studentëve të programit të studimit, e cila organizohet në tre semestra. Pedagogët dhe DPPS ndihmohet nga këta personel administrativë: 1 (një) laborante pranë departamentit, 1 (një) sekretare e procesit mësimor dhe zyra e IT-së. Përsa i përket stafit akademik të DPPS-së, ajo është si më poshtë: - 2022-2023, 22 PAE (1 Prof. Dr., 12 Prof. As., 7 Dr., 2 Msc) dhe 68 PAK (3 Prof.As., 19 Dr., 46 Msc)

	- 2023-2024, <i>GVJ nuk gjeti informacion mbi këtë periudhë dhe në tërësi tabelat e ofruara nga IAL krijojnë konfuzion.</i> Evidenca: <i>1.7. Rregullore për vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmes akademike dhe administrative.</i> <i>2.5. Struktura organizative e FSHS 2024.</i> <i>4.12 2022-2023 Tabele përmbledhese numri PAE PAK</i> <i>4.4 (3) Manual për praktikantët e studentëve.</i>			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinators të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Siç sqarohet më sipër, në standardin I.3 kriteri 1, DPPS ka caktuar 1 (një) koordinators të programit të studimit. Në bazë të Rregullores së programit të studimit (nenet 11-13) koordinators mbikqyr funksionimin e programit të studimit dhe së bashku me përgjegjësin e njësies bazë siguron mbarrëvajtjen e procesit mësimor, praktikave dhe të nevojave të tjera relevante. Evidencat: <i>3.11. Vendim për caktimin e koordinators të programeve të studimit të vitit 2017</i> <i>3.6. Rregullore e programit të studimit Master Shkencor ' Administrim i Shërbimeve Sociale'</i>			
Konkluzione	DPPS, në koordinim me FSHS, përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin, në lidhje me organizimin dhe strukturën akademike, vlerësimin dhe akreditimin. Ato angazhojnë personelin akademik dhe administrativ për realizimin e praktikave profesionale, si dhe caktohet një koordinators përgjegjës për mbikqyrjen e punës në programin e studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën	DPPS ka hartuar dhe zbaton programin e studimit në bazë të informacionit sipas legjislacionit në fuqi. Kështu, është organizuar struktura e programit të studimit me lëndët e formimit të përgjithshëm, të përgatitjes disiplinore, të formimit ndërdisiplinor dhe atyre që përcjellin njohuri plotësuese, së bashku me detyrimet përmblylëse.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423


Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Informacioni i nevojshëm pasqyrohet në dokumentacionin bazë të këtij programi studimi, siç janë korniza konceptuale, plani mësimor dhe programet lëndore, si dhe rregullorja e programit. Informacioni në planin mësimor dhe në programet lëndore është shprehur në elementë cilësorë (tematikat, lëndët) dhe sasiorë (orët mësimore dhe jashtë auditorit, ngarkesa mësimore, kreditet ETCS, etj). Evidenca: 3.6. Rregullore e programit të studimit Master Shkencor ' Administrim i Shërbimeve Sociale. 4.1. Korniza konceptuale e programit të studimit. 4.2. 2022- 2023, 2023 - 2024 Plani i miratuar mësimor i programit të studimit. 4.2.2 Plani Mesimor i ndare sipas veprimtarive AF. 4.3 Programi i lëndëve mësimore në Gjuhën Shqipe. 4.5. Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës.
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi mësimor përmban planin mësimor, i organizuar në 15 lëndë të tipologjisë A deri në F, të cilat i përkasin gjithësej 120 kredite ETCS dhe të shtrira në një hapësirë kohore prej dy vitesh. Më konkretisht, plani mësimor përmban: - A: Lëndë të formimit të përgjithshëm e metodologjik (18 kredite) - 3 lëndë ose 15% e planit mësimor; - B: Lëndë për përgatitjen e disiplinës shkencore (42 kredite) -7 lëndë ose 35% e planit mësimor; - C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese (12 kredite) - 2 lëndë ose 10% e planit mësimor; - E: Praktika profesionale (18 kredite) - 3 lëndë ose 15% e planit; - F: Lëndë përmbyllëse (mikroteza) - 30 kredite ose 25% e planit mësimor. Gjithsej 120 kredite ETCS – 100% e planit mësimor. <i>Megjithatë rezulton se lëndët e këtij programi studimi janë kategorizuar nga A në F dhe jo sipas VKM-së nr. 41 dt. 24/01/2018 nga A në E. Kjo u ngrit si problematikë edhe nga anëtarët e GVB-së gjatë vizitës në institucion.</i> Evidenca: 3.6. Rregullore e programit të studimit Master Shkencor ' Administrim i Shërbimeve Sociale. 4.2. 2022- 2023, 2023 - 2024 Plani i miratuar mësimor i programit të studimit.

	4.2.2 <i>Plani Mesimor i ndare sipas veprimtarive AF.</i> 4.5. <i>Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës.</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme që lidhen me kriteret e pranimit, si dhe me transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve. Ndiqen kriteret e përgjithshme pranimi, të përcaktuara nga kuadri ligjor në fuqi, si dhe kriteret specifike të propozuara nga DPPS dhe FSHS çdo vit. --Kriteret e përgjithshme janë: A. Mbarimi i shkollës së mesme; B. Plotësimi i kriterit të notës mesatare; C. Respektimi i kuotave të propozuara nga DPPS dhe të miratuara nga Senati Akademik i UT; --Kriteret specifike janë: A. Gjuha e huaj e çertifikuar. B. Kanë përparësi studentët e FSHS dhe të UT. DPPS mundëson transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve në bazë të Statutit dhe të Rregullores së UT, si dhe të dokumentacionit rregullator të fakultetit dhe të departamentit. Evidenca: 1.2. <i>Statuti i UT</i> <https://unitir.edu.al/ep-content/uploads/2019/08/Statuti_2018.pdf> 1.22. <i>Kriteret e pranimit 2024-2025.</i> 1.3. <i>Rregullore e UT</i> <https://unitir.edu.al/rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022/> 2.31. <i>Ngritja e grupeve të punës për pranimet e reja në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve në Fakultetin e Shkencave Sociale, për vitin akademik 2024-2025.</i> 2.3.6. <i>Rregullore e programit të studimit Master Shkencor ' Administrim i Shërbimeve Sociale</i> 2.4. <i>Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023.</i> 3.14 <i>Vendim për miratimin e kriterëve të pranimit në ciklin e dytë të studimeve në UT, për vitin akademik 2022-2023.</i> 3.14.1. <i>Vendim departamenti për ngritje komisioni ad - hoc pranimi në programin e ciklit të dytë të studimeve.</i> 3.3. <i>Rregullore e Departamentit të Punës dhe Politikës Sociale.</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë	Programi i studimit përmban programet lëndore (silabuset) e detajuara sipas formatit të miratuar nga Senati Akademik i UT. Silabuset detajohen në përputhje me kërkesat ligjore, duke ofruar informacionet e mëposhtme: organizimin tematik, objektivat e lëndës, metodat e mësimdhënies dhe të vlerësimit, përkatësinë me

për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	kredite dhe me orë studimi brenda dhe jashtë auditorit, format e frekuentimit dhe pjesëmarrjes, si dhe literaturën e detyruar dhe të rekomanduar. Silabusi miratohet çdo vit nga përgjegjësi i departamentit dhe nga dekani. Nga takimi me studentët na u pohua që pedagogët janë transparentë me informimin e studentëve për të gjitha elementët përbërës të lëndës sipas silabusit përkatës. Evidenca: 4.2. 2022- 2023, 2023 - 2024 Plani i miratuar mësimor i programit të studimit. 4.2.1. Plani mësimor sipas modelit të Tabelës 10. 4.2.2 Plani Mesimor i ndare sipas veprimtarive AF. 4.3 Programi i lëndëve mësimore në Gjuhën Shqipe.
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Në fillim të vitit akademik ndërmerren përmirësime të programit të studimit dhe të programeve lëndore, në respekt të lirisë akademike dhe të gjykimit të departamentit sipas vlerësimeve të marra nga studentët. Ndryshimet kurrikulare deri në 20% miratohen nga Senati Akademik. <i>Rekomandohet organizimi i tryezave të rrumbullakëta me përfaqësues të institucioneve partnere, të biznesit, me studentët e diplomuar (alumni) dhe me studentët, ku të shprehen vlerësime konkrete për eficiencën e programit kurrikular me kërkesat e tregut të punës. Kjo do të ndihmonte në përmirësimet e studiuara kurrikulare dhe që i rezistojnë kohës.</i> Evidenca: 2.14. Informacion për politikën e zhvillimit dhe të përmirësimit të kurrikulave. 3.5. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit Master Shkencor në 'Administrim i Shërbimeve Sociale' 2020 - 2024. 4.2. 2022- 2023, 2023 - 2024 Plani i miratuar mësimor i programit të studimit. 4.2.3. Ndryshimet në planin mësimor, krahasuar me programet e liçensuara
Konkluzione	Programi i studimit është i detajuar, informues dhe i strukturuar në përputhje me strategjinë dhe me objektivat formuese. Përmirësimet kurrikulare kryhen në përputhje të legjislacionit në fuqi, të lirisë akademike dhe të nevojës për rritjen e eficiencës së programit të studimit. Rekomandohen më tepër takime me palët partnere për dëgjimin e propozimeve të tyre në lidhje me përmirësimin e programit të studimit për sa i përket kërkesave të tregut të punës.




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4


Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Organizimi i planit mësimor dhe i programeve lëndore të programit të studimit kryhen në përputhje me kornizën konceptuale të programit dhe kanë qëllim ndërthurjen e njohurive të thelluara me përgatitjen e ekspertëve në fushën e administrimit të shërbimeve sociale. Kjo realizohet nëpërmjet kombinimit të leksioneve dhe seminareve me orët e kushtuara në praktikën profesionale. Thellimi i njohurive siguron aftësi të konsoliduara për studime të mëtejshme në ciklin e tretë të studimeve. Evidenca: 4.1. Korniza konceptuale e programit të studimit. 4.2. 2022- 2023, 2023 - 2024 Plani i miratuar mësimor i programit të studimit. 4.3 Programi i lëndëve mësimore në Gjuhën Shqipe. 4.4 (3) Manual për praktikat e studentëve.
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Shpërndarja e ngarkesës është e balancuar në vite dhe semestra, me qëllim arritjen e objektivave formuese të programit të studimit. Fillohet me lëndët bazë të detyrueshme, të cilat ofrojnë përgatitje teorike dhe metodologjike, pra kulturë të përgjithshme, dhe vazhdohet më pas me lëndët karakterizuese që ofrojnë aftësi profesionale për fushën e studimit. Në lëndë të caktuara aplikohen detyra kursi, me anë të së cilave synohet prezantimi i rezultateve të punimeve të studentëve. Evidenca: 4.1. Korniza konceptuale e programit të studimit. 4.2. 2022- 2023, 2023 - 2024 Plani i miratuar mësimor i programit të studimit.
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e	Struktura e programit të studimit është në përputhje me profilin e programit të studimit, në respekt të legjislacionit shqiptar, por edhe në harmoni me parimet e Kartës së Bolonjës dhe Sistemit Evropian të Transferimit dhe Mbledhjes së Krediteve (ETCS).



programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Në hartimin e programit të studimit, departamenti nënvizon se u morën parasysh modelet e universiteve prestigjioze evropiane. <i>Rekomandohen studime periodike të kurrikulës së universiteve prestigjioze evropiane për të parë se cilat janë prirjet kryesore që shoqërojnë përmirësimet kurrikulare. Këto studime dhe përshtatje të kurrikulës së programit të studimit duhen evidentuar me dokumentacion.</i> Evidenca: 3.5. <i>Strategjia e zhvillimit të programit të studimit Master Shkencor në 'Administrim i Shërbimeve Sociale' 2020 - 2024.</i> 4.1. <i>Korniza konceptuale e programit të studimit.</i> 4.2. <i>2022- 2023, 2023 - 2024 Plani i miratuar mësimor i programit të studimit.</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Kurrikula e programit të studimit siguron pajisjen e studentëve me njohuritë e nevojshme teorike dhe mundëson arritjen e objektivave formuese nëpërmjet formimit praktik. Praktika profesionale, e cila fillon në semestrin e dytë të vitit të parë, është element thelbësor që aftëson studentin në tregun e punës, duke njohur më mirë kërkesat e kësaj të fundit. Formimi i thelluar teorik u mundëson studentëve vazhdimin e ciklit të tretë të studimeve. Evidenca: 3.6. <i>Rregullore e programit të studimit Master Shkencor ' Administrim i Shërbimeve Sociale'.</i> 4.2. <i>2022- 2023, 2023 - 2024 Plani i miratuar mësimor i programit të studimit.</i> 4.3 <i>Programi i lëndëve mësimore në Gjuhën Shqipe.</i> 4.4 (3) <i>Manual për praktikat e studentëve.</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Sipas nenit 21 (programi i lëndës) të rregullores së programit të studimit, çdo titullar ka detyrim të paraqesë programet e lëndëve në fillim të vitit akademik dhe në çdo rast përpara fillimit të procesit mësimor të lëndës. Edhe gjatë vizitës në institucion, na u tha nga stafi akademik se programet lëndore (silabuset) përmirësohen çdo vit nga pedagogu titullar në respekt të lirisë akademike, dhe më pas miratohen nga përgjegjësi i departamentit dhe nga dekani. Kujdes i veçantë i kushtohet përditësimit të tematikave me aktualitetin e dijes si dhe përditësimit të literaturës më të fundit, kryesisht e 5 (pesë) viteve të fundit. Kjo mund të jetë literaturë e detyrueshme ose e rekomanduar, në bashkëpunim edhe me sektorin e bibliotekës, me qëllim lehtësimin e studentit në aksesimin e burimeve. Megjithatë, nga shqyrtimi i të gjitha silabuseve të programit të studimit për vitet


	2022 dhe 2023 rezulton se disa prej tyre nuk kanë literaturë të përditësuar, si psh lëndët: Teoritë dhe zhvillimet e reja sociale (literatura e fundit 2018), Metoda të avancuara të kërkimit shkencor (literatura e fundit 2014), Vlerësimi i programeve dhe politikave sociale (literatura e fundit 2011), Zhvillimi i fondeve në organizatat e shërbimeve sociale (literatura e fundit 2017), Zhvillimi dhe administrimi i burimeve njerëzore në shërbimet sociale (literatura e fundit për vitin 2023 është e vitit 2017), Buxhetim, planifikim dhe menaxhim financiar në organizatat e shërbimeve sociale (literatura e fundit 2013), Supervizim në organizatat e shërbimeve sociale (literatura e fundit 2002), Punë sociale në makro – planifikim strategjik (literatura e fundit 2017). <i>Rekomandohet përditësimi i literaturës në programet lëndore.</i> Evidenca: 2.25.1. Të dhëna të plota për platformat on-line tabela 17. 2.27. Dokument mbi librat e fundit për bibliotekën. 3.6. Rregullore e programit të studimit Master Shkencor ' Administrim i Shërbimeve Sociale'. 4.3 Programi i lëndëve mësimore në Gjuhën Shqipe. Evidenca: 2.25.1. Të dhëna të plota për platformat on-line tabela 17. 2.27. Dokument mbi librat e fundit për bibliotekën. 3.6. Rregullore e programit të studimit Master Shkencor ' Administrim i Shërbimeve Sociale'. 4.3 Programi i lëndëve mësimore në Gjuhën Shqipe.
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Përmbajtja e programit dhe kurrikula e saj garanton përftimin e njohurive të thelluara teorike dhe të aftësive praktike për të dalë si profesionist në tregun e punës. Përmirësimet e silabusave dhe ato kurrikulare kanë si qëllim aktualizimin e programit të studimit me problematikat bashkëkohore - përtej atyre klasike – dhe me nevojat aktuale të tregut të punës. Pozitiv është ndërmarrja e studimit të tregut të punës nga UT dhe kryesisht nga DPPS, i cili përbën një studim prestigjioz për sa i përket njohjes së nevojave të tregut por edhe kontekstit të kërkimit shkencor në bashkëpunim me AKKSHI-n. <i>Rekomandohet një bashkëpunim më i institucionalizuar dhe formalizuar me institucionet partnere dhe biznesin (psh në formën e tryezave të rrumbullakëta dhe diskutimeve sistematike) me qëllim që programi i studimit të jetë sa më i prekshëm për nevojat aktuale të shoqërisë shqiptare.</i>



	Evidenca: 1.26. Studimi-i-tregut-te-punes _UT 2022. 2.14. Informacion për politikën e zhvillimit dhe të përmirësimit të kurrikulave. 4.2. 2022- 2023, 2023 - 2024 Plani i miratuar mësimor i programit të studimit. 4.3 Programi i lëndëve mësimore në Gjuhën Shqipe. 4.9.1. Analizë e tregut të punës.			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi i studimit në përmbajtjen e tij përcjell njohuri të thelluara teorike dhe raste studimi, me qëllim që studenti të aftësohet për vazhdimin e ciklit të tretë të studimeve. Paralelisht, praktika institucionale dhe njohja me tiparet e shërbimeve sociale të shoqërisë shqiptare e përgatit studentin për t'u përballur me kërkesat e tregut të punës. Rekomandohet pasurimi i kurrikulës me lëndë që i referohen vendeve të BE-së ose/dhe OECD-së, apo edhe e vendeve të tjera, me qëllim që studenti të aftësohet edhe në hapësira të tjera më të gjera. Evidenca: 4.1. Korniza konceptuale e programit të studimit. 4.2. 2022- 2023, 2023 - 2024 Plani i miratuar mësimor i programit të studimit. 4.9.1. Analizë e tregut të punës.			
Konkluzione	Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Programi i studimit i aftëson studentët me njohuri të thelluara për vazhdimin e studimeve në ciklin e tretë. Gjithashtu, struktura e programit siguron aftësi kompetencash praktike, me qëllim përballjen e suksesshme me tregun e punës. Rekomandohet përditësim i kurrikulës me prirjet e vendeve të BE/OECD, duke i shërbyer ndërkombëtarizimit të tregut të punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Në përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit merren parasysh kërkesat e tregut të punës, të cilat UT dhe DPPS i kanë matur në studime të veçanta. Vlen të theksohet Analiza e tregut të punës për profesionistët e punës sociale dhe administrimin e shërbimeve sociale në Shqipëri, studim të cilin departamenti e realizoi në bashkëpunim me AKKSHI-n dhe u botua në vitin 2024. Gjithashtu, në takim me studentët dhe me stafin akademik u theksua nga të dyja palët se DPPS është i hapur për të pritur dhe analizuar sugjerimet që vijnë nga studentët. Pozitive është gjithashtu ktijimi i një ëeb-i të veçantë (digjitale.sociale.al) që shërben si hapësirë për qarkullimin e mendimit konstruktiv dhe për bashkëpunimet e mundshme. Evidenca: 1.26. <i>Studimi-i-tregut-te-punes UT 2022.</i> 3.21. <i>Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese për programin e studimit dhe për Praktikën profesionale.</i> 3.30. <i>Studim i tregut në lidhje me statusin e punësimit të studentëve dhe të të diplomuarve.</i> 4.9.1. <i>Analizë e tregut të punës.</i> -- <http://digjitale.sociale.al/rreth-nesh/>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Komunikimi me studentët realizohet përmes kontakteve që Shërbimi i Karrierës, si pjesë përbërëse e FSHS, vendos me ta, kryesisht përmes pyetësorëve dhe krijimit të të dhënave pas diplomimit, kryesisht në lidhje me punësimin e tyre. Gjithashtu, studentët pyeten periodikisht nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) dhe në raportet e saj reflektohen rregullisht mendimet e studentëve. Studentët kanë organet e tyre përfaqësuese dhe si rregull ata kanalizojnë nëpërmjet tyre kërkesat ndaj institucionit. DPPS dhe FSHS ka qenë gjithmonë mikëpritës ndaj kërkesave të studentëve dhe kjo na u vu në dukje edhe gjatë takimit që zhvilluam me këta të fundit. Në kuadrin e dëgjimit të mendimit të studentëve, DPPS ka ndërmarrë anketime që matin kënaqësinë e tyre në lidhje me cilësinë e mësimdhënies. Në RVB thuhet se DPPS organizon diskutime të strukturuar me studentët në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. Kjo është një ndërmarrje pozitive, megjithatë, rekomandohen forma të institucionalizuara dhe të dokumentuara të ndërveprimit me studentët për sa i përket marrjes së mendimit




	<i>të tyre në lidhje me studimet e kryera dhe sfidat me të cilat ata ndeshen në tregun e punës. Kështu, përtej pyetësorit të shërbimit të karrierës, DPPS mund të organizojë tryeza vjetore të rrumbullakëta me studentët efektivë dhe ata të diplomuar, ku të diskutohen përditësimet e mundshme të programit të studimit me qëllim që ai të jetë sa më eficient.</i> Evidenca: 1.23. Rregullore për zgjedhjet e këshillave të studentëve në Universitetin e Tiranës. 2.14. Informacion për politikën e zhvillimit dhe të përmirësimit të kurrikulave.pdf 2.22. Rregullore e Zyrës së Këshillimit për Karrierë 2021. 2.23. Politika për mbështetjen për studentët dhe strukturat e tyre organizative. 3.21.1 Tabelë përmbledhëse me trajnime, konkurse, praktika profesionale, intership dhe mundësi punësimi për studentër e diplomuar. 3.23 Raport i anketimit mbi kënaqësinë e studentëve për cilësinë e mësimdhënies në FSHS, UT viti akademik semestri I, 2022 - 2023. 3.23.1. Raport i anketimit mbi kënaqësinë e studentëve për cilësinë e mësimdhënies në FSHS, UT viti akademik semestri II, 2022 - 2023. 3.23.2. Raport i anketimit mbi kënaqësinë e studentëve për cilësinë e mësimdhënies në FSHS, UT viti akademik semestri I, 2023-2024. -- https://fshs-ut.edu.al/rreth-fakultetit/sherbimi-i-karrieres
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	DPPS ka ndërmarrë një studim të profilizuar tregu për profesionet që lidhen me programet e studimit të ofruara nga ky departament. Kjo është një ndërmarrje për tu përshëndetur, e cila konkretizon studimin e përgjithshëm të tregut në nivel IAL (UT) me të dhëna që i afrohen njësisë bazë. Gjithashtu pozitive janë marrëdhëniet e DPPS me Urdhërin e Punonjësit Social në kuadrin e programit të studimit <i>Punë Sociale</i>. Duke qenë se nuk ka një Urdhër për punonjësit e administrimit të shërbimeve sociale, rekomandohen forma të institucionalizuara dhe të dokumentuara të ndërveprimit me institucione partnere dhe aktorë të rëndësishëm socialë për sa i përket marrjes së mendimit të tyre në lidhje me eficiencën e programit të studimit në nevojat që dikton tregu i punës. Kështu, DPPS mund të organizojë tryeza vjetore të rrumbullakëta ku të diskutohen përditësimet e mundshme kurrikulare, qoftë në lëndë të caktuara, por edhe për sa i përket raportit të orëve teorike me ato praktike.

	Evidenca: 3.15. Procedura e ndjekur për përmirësimin e kurrikulës e programeve të studimit.pdf 3.21. Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese për programin e studimit dhe për Praktikën profesionale.pdf			
Konkluzione	DPPS nxit përfshirjen e studentëve dhe të institucioneve partnere në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. Megjithatë, rekomandohen forma të institucionalizuara dhe periodike me ta, me qëllim vjeljen e feedback-ut të tyre për sa i përket efikasitetit të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e vendosura.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi i studimit është në përputhje me objektivat madhorë të UT si IAL, dhe konkretisht me mësimdhënien cilësore, kërkimin shkencor dhe përgatitjen profesionale. Drejtimet prioritare akademike përcaktohen nga Statuti dhe Rregullorja e UT, së bashku me strategjinë institucionale. Përmirësimi i mësimdhënies ndërmerret nëpërmjet matjeve periodike dhe raporteve përkatëse. Performanca e kërkimit shkencor sigurohet si rezultat i punës së stafit të angazhuar por edhe e konferencave vjetore që DPPS organizon në fushën e punës sociale. Përveç diskutimeve teorike dhe shkëmbimit të përvojave në këto konferenca, këto të fundit shërbejnë për rrjetëzimin dhe bashkëpunimin e pjesëmarrësve. Edhe pse programi i studimit siguron përgatitjen e profesionistëve në fushën e administrimit të shërbimeve sociale, nga takimet me stafin e angazhuar dhe me studentët <i>u vlerësua si nevojë krijimi i një Urdhëri për punonjësit e administrimit të shërbimeve sociale, i cili do të mbronte dhe promovonte më mirë këtë profesion.</i> Evidenca: 1.2. Statuti i UT <https://unitir.edu.al/ep-content/uploads/2019/08/Statuti_2018.pdf> 1.3. Rregullore e UT <https://unitir.edu.al/rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022/>

	1.4. Strategjia e UT <https://unitir.edu.al/strategjia-e-zhvillimit-te-universitetit-te-tiranes-per-periudhen-2023-2028/> 3.22 Politika për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. 4.1. Korniza konceptuale e programit të studimit. 4.6. Veprimtaria kërkimore në DPPS (2022 - 2023). 4.7. Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit (Tabela 6).
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	DPPS nxit përmirësimin e veprimtarisë së mësimdhënies në realizimin e procesit mësimor me atë të kërkimit shkencor, duke respektuar lirinë akademike të pedagogut. Paralelisht me raportet periodike të NJSBC-së dhe vlerësimin e performancës në nivel vertikal nga përgjegjësi i departamentit, pedagogu mat performancën e vet në përfundim të një moduli, me qëllim përmirësimin e mundshëm të mësimdhënies. Kjo na u konfirmua nga takimi me stafin akademik dhe me studentët. Stafi ka një përvojë të konsoliduar jo vetëm në mësimdhënie, por edhe në veprimtarinë shkencore. Ai është i angazhuar në pjesëmarrjen në konferenca të ndryshme shkencore si dhe në shkrimin e punimeve shkencore relevante me fushën e studimit. Në kontekstin e ndërthurrjes së cilësisë së mësimdhënies dhe përvojës institucionale – shkencore, DPPS organizon leksione dhe orë të hapura me personalitete të rëndësishme të fushës së studimit. Evidenca: 3.22 Politika për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. 3.24. Dosje e leksioneve, aktiviteteve, konferencave të hapura. 4.6. Veprimtaria kërkimore në DPPS (2022 - 2023). 4.7. Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit (Tabela 6).
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	DPPS nxit studentët të angazhohen në studime, aktivitete shkencore dhe projekte kërkimore. Kjo na u konfirmua në takimet me stafin akademik dhe me studentët, ku u theksua se janë shfrytëzuar mundësitë për pjesëmarrjen e studentëve në projektet kërkimore-shkencore, në prezantimin e punimeve në konferenca shkencore në bashkautorësi me pedagogë të programit të studimit si dhe në projektet kërkimore-shkencore. DPPS angazhon studentët në hartimin e detyrave të kursit ku studentët aftësohen në hulumtimin e burimeve shkencore dhe përgatiten kështu gradualisht për punimin e tyre të diplomës. Studentët mund të shfrytëzojnë informacionit që jepet në Këndin Digjital të ëeb-it të krijuar me kontributin e stafit të DPPS <https://digjitale.sociale.al/>

	Studentët e programit të studimit marrin pjesë në konferencën shkencore vjetore që organizohet në nivel UT, por edhe në konferencën vjetore që DPPS organizon në bashkëpunim me universitetet e Elbasanit dhe të Shkodrës. Studentët kanë gjithashtu mundësi të marrin pjesë në programet e mobilitetit me institucionet partnere të UT, diçka që nuk është shfrytëzuar maksimalisht nga studentët e këtij programi studimi. Rekomandohet një informacion i detajuar në lidhje me mundësitë që ofrohen për studentët dhe sa shfrytëzohen këto mundësi. Përtej organizimit të dokumentacionit është i nevojshëm informimi periodik i studentëve në lidhje me mundësitë që ofrohen. Evidenca: 3.20 <i>Te dhena per mobilitetin e studenteve.pdf</i> 13.6.1 <i>Broshurë informative.</i> -- <https://digjitale.sociale.al/>			
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Për realizimin e veprimtarisë studimore dhe kërkimore-shkencore, UT mbështet njësinë bazë me një fond të dedikuar në formë Grandi, në varësi të kërkesave të dokumentuara me shpenzime. Një numër pedagogësh nga DPPS (rreth katër prej tyre) kanë përfituar nga Grandi i vënë në dispozicion. Gjithashtu, UT dhe FSHS ndihmon departamentin në aplikimin e projekteve kërkimore-shkencore dhe ato infrastrukturore në nivel BE (fondet Erasmus+). Nga takimi me sektorin e projekteve na u konfirmua një angazhim i kënaqshëm i stafit në projektet me BE-në, ku në të gjitha janë përfshirë edhe studentët. Këto cilësohen si hapa të rëndësishme në ndërkombëtarizimin e programit të studimit, edhe pse mbetet akoma shumë për tu bërë. Evidenca: 1.18. <i>Vendim BA Për miratimin e programit të Grantit per konferenca ndërkombëtare.pdf</i>			
Konkluzione	<i>Programi i studimit garanton orientimin në fushën e studimeve dhe të kërkimit shkencor, qoftë nëpërmjet ndërthurjen e kërkimit shkencor me veprimtarinë kërkimore-shkencore, por edhe në përfshirjen e studentëve në veprimtarinë kërkimore-shkencore. Rekomandohet një informacion i organizuar dhe i detajuar në lidhje me përfshirjen e studentëve dhe shfrytëzimin e mundësive të ekzistojnë, duke u paraprirë nga informimi dhe ndërgjegjësimi i studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	DPPA siguron realizimin e grupeve lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore nga ana e stafit akademik në bashkëpunim me studentët. Me qëllim pasurimin e përvojës së studentëve me profesionin e administrimit të shërbimeve sociale, departamenti organizon leksione të hapura me ekspertë të fushës. Gjithashtu, për të forcuar lidhjet me tregun e punës janë afruar si pedagogë të jashtëm (PAK) përfaqësuesë të institucioneve me të cilat departamenti apo njësitë më sipër tij kanë marrëveshje bashkëpunimi. Evidenca: 3.18. Raportet vjetorë të departamentit për vitet 2022-2023 dhe 2023-2024. 3.19. Raport periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshja e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit. 3.21.1. Tabela përmbledhëse me trajnime, konkurse, praktika profesionale, intership dhe mundësi punësimi për studentët e diplomuar. 3.24. Dosje e leksioneve/aktiviteteve/konferencave të hapura. 4.11. Të dhëna për aktivitetet për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të personelit akademik në 5 vitet e fundit.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	DPPS angazhon personelin akademik PAE dhe PAK për ndërmarrjen e studimeve të ndryshme në bashkëpunim me studentët. Në RVB përmenden një sërë veprimtarish shkencore, si leksione të hapura, trajnime intensive (bootcampe), sesione digjitale nëpërmjet platformës <i>sociale.al</i>, si dhe synimi për tu hapur edhe ndaj ndërkombëtarizimit të dijes nëpërmjet aksesit tek programet Erasmus. Interesi i lartë i departamentit në ndërkombëtarizimin e dijes na u konfirmua edhe nga zv. dekania që mbulon kërkimin shkencor dhe projektet, e cila vuri në dukje projektet ndër-departamentare në bashkëpunim me Ambasadën Zvicerane dhe Unicef-in. Gjithashtu, dekani dhe përgjegjësi i departamentit na konfirmuan përgatitjen e lartë të stafit akademik dhe përvojën e gjatë në trajnime dhe ekspertiza.

	<i>Duke u nisur nga përvoja e fortë, departamenti mund të binjakëzohet me departamente simotra nga universitete në vendet e Bashkimit Evropian në fushën e administrimit të shërbimeve sociale dhe fushave të ngjashme, ku të ndërmerren hapa të koordinuara dhe të institucionalizuara, si psh trajnime të certifikuara duale, konferenca, publikime, projekte, etj.</i> Evidenca: 3.18. Raportet vjetorë të departamentit për vitet 2022-2023 dhe 2023-2024. 3.21.1. Tabela përmbledhëse me trajnime, konkurse, praktika profesionale, intership dhe mundësi punësimi për studentët e diplomuar. 3.24. Dosje e leksioneve/aktiviteteve/konferencave të hapura. 4.6. Veprimtaria kërkimore në nivel programi studimi (2022-2024). -- <https://digjitale.sociale.al/>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Siç shkruhet në kriterin 1 të këtij standardi, departamenti ka një përvojë të gjatë në organizimin e konferencave dhe veprimtarive shkencore, të cilat ndihmojnë pedagogët dhe studentët në arritjen e objektivit të kërkimit shkencor. Në takimin e stafin akademik u përmend një konferencë periodike për punën sociale dhe shërbimet sociale që njësia bazë organizon me departamente simotra nga universiteti i Shkodrës dhe ai i Durrësit. <i>Rekomandojmë hartimin e botimeve konkrete pas përfundimit të konferencave dhe veprimtarive të tjera shkencore në nivel të ngjashëm, të cilat do të pasuronin literaturën respektive në shqip dhe do të vijnë në ndihmë të studentëve dhe të studiuesve të tjerë.</i> Evidenca: 3.18. Raportet vjetorë të departamentit për vitet 2022-2023 dhe 2023-2024. 3.24. Dosje e leksioneve/aktiviteteve/konferencave të hapura. 4.6. Veprimtaria kërkimore në nivel programi studimi (2022-2024).
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Programi i studimit formon tek studentët njohuri të thelluara dhe i përgatit ata me aftësi profesionale për administrimin e shërbimeve sociale. Kjo realizohet nëpërmjet praktikës profesionale, kontakteve me ekspertë të fushës falë orëve të hapura, trajnimeve të ofruara, aksesit në konferenca dhe aktivitete të tjera kërkimore-shkencore në dhe temës së diplomës në studimin e rasteve të veçanta.

	<i>Rekomandojmë koordinim më frytdhënës me zyrën e karrierës dhe alumnit, me qëllim që studentët të jenë të përditësuar me trajnime të nevojshme dhe aftësi të tjera që do t'i lehtësojnë ata në tregun kombëtar të punës. Gjithashtu, rekomandojmë nxitje të studentëve për t'u përfshirë në mobilitetet e programit Erasmus+ për sa i përket programeve semestralë dhe praktikave të punës për studentët alumni, të cilat do të aftësonin studentët në tregun ndërkombëtar të punës. Këto të dëshmojnë me informacion të organizuar në akreditimet e ardhshme.</i> Evidenca: 3.5. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit Master Shkencor në 'Administrim i Shërbimeve Sociale' 2020 – 2024. 3.18. Raportet vjetorë të departamentit për vitet 2022-2023 dhe 2023-2024. 3.24. Dosje e leksioneve/aktiviteteve/konferencave të hapura. 4.1. Korniza konceptuale e programit të studimit.
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Kriter nuk i përket këtij programi studimi duke qenë se ky i fundit nuk rregullohet nga ndonjë Urdhër i veçantë. Megjithatë, bashkëpunimi që DPPS ka me Urdhërin e punonjësve social në kuadrin e një programi tjetër studimi mund të ravijëzojë ide dhe propozime të veçanta që prekin tregun e punës në fushat e përafërta me punën sociale. <i>Rekomandohet lobim i DPPS dhe FSHS që profesioni i administrimit të shërbimeve sociale të rregullohet nga një urdhër i veçantë.</i> Evidenca: - Urdhëri i punonjësve socialë <https://urdhriipunonjesvesociale.al/>
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Nuk aplikohet.
Konkluzione	<i>Programi i studimit garanton njohuri të thelluara dhe aftësi profesionale në përgatitjen e studentit për tregun e punës por edhe</i>

	për vazhdimin e ciklit të tretë të studimeve. Rekomandohet bashkëpunime të tjera që përmes ndërkombëtarizimit të dijes dhe shkëmbimit të përvojave do të lehtësojnë studentët në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve në programin e studimit janë leksionet, seminarët, orët e hapura, detyrat e kursit, esetë, projektet dhe praktikatat profesionale pranë institucioneve partnere, publike dhe jo publike. Këto përmbushin ndërthurjen e orëve teorike dhe praktike, të cilat së bashku me sjelljen e përvojave përmes orëve të hapura synojnë të komplotojnë tek studentët kapacitetet e nevojshme profesionale. Evidenca: 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023. 2.10. Baza rregullatore për mësimdhënien, të nxënës dhe provimet. 3.21. Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese për programin e studimit dhe për Praktikën profesionale. 3.21.1. Tabela përmbledhëse me trajnime, konkurse, praktika profesionale, intership dhe mundësi punësimi për studentët e diplomuar. 3.24. Dosje e leksioneve/aktiviteteve/konferencave të hapura. 3.6. Rregullore e programit të studimit Master në Administrim i shërbimeve sociale. 4.3. Programet e lëndëve mësimore në Gjuhën shqipe. 4.4 (3) Manual për praktikatat e studentëve.

Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	DPPS respekton diversitetin e studentëve dhe aplikon akses të barabartë në dije përmes formave të larmishme të mësimdhënies, të cilat janë paraprakisht të parashikuara në rregullore, në planin mësimor si dhe në programet lëndore të përditësuara. Këto janë format klasike të mësimdhënies (leksione dhe seminare) por edhe forma inovative si analiza, diskutime me në qendër studentin, simulime, studime rasti, projekte në grup, mjete audio-vizive, etj. Sipas dokumentacionit studentët shprehen të kënaqur për sa i përket cilësisë së mësimdhënies dhe kjo gjendet e matur në anketën përkatëse mbi kënaqësinë e studentëve për cilësinë e mësimdhënies. Megjithatë, në takimin me studentët u sugjeruan më shumë orë praktike dhe shmangie të temave të ezauaruara në lëndët e mëparshme të studimeve në ciklin bachelor. Rekomandohet hartimi i një manuali të veçantë në departament në lidhje me format e mësimdhënies, të pasuruar nga përvojat dhe propozimet e stafit akademik, si dhe nga propozimet e studentëve. Evidenca: 3.23. a & b. Raporti i anketimit mbi kënaqësinë e studentëve për cilësinë e mësimdhënies në FSHS. 3.6. Rregullore e programit të studimit Master në Administrim i shërbimeve sociale. 4.2. 2022- 2023, 2023 - 2024 Plani i miratuar mësimor i programit të studimit. 4.2.1. Plani mësimor sipas modelit të Tabelës 10. 4.2.2 Plani Mesimor i ndare sipas veprimtarive AF. 4.3 Programi i lëndëve mësimore në Gjuhën Shqipe.
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	UT dhe FSHS mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, duke krijuar platforma të veçanta trajnimi, siç është psh Qendra për Zhvillimin Profesional në nivel IAL. Në takimin me dekanin dhe përgjegjësin e departamentit na u konfirmua se si rregull FSHS krijon kushtet e nevojshme nëse departamenti kërkon trajnime për përmirësimin e mëtejshëm të kompetencave didaktike. Evidenca: 1.20. Vendimi i Senatit Akademik për ngritjen e Qendrës Virtuale të Trajnimit dhe Zhvillimit Profesional. 1.25. Plani strategjik i UT për zhvillimin e personelit akademik 2023-2028.

	2.20. <i>Politika e FSHS për zhvillimin profesional të personelit akademik.</i> -- <i>Qendra për Zhvillimin Profesional në UT</i> <https://unitir.edu.al/qender-virtuale-e-trajnim-it-dhe-zhvillimit-profesional/>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	DPPS ka në përbërjen e tij një staf të kualifikuar dhe me përvojë në mësimdhënie prej 22 pedagogësh. Një pjesë e tyre ka përfunduar studimet universitare dhe pasuniversitare në universitetet prestigjioze të vendeve të Bashkimit Evropian, duke qenë i gatshëm të ofrojë pranë UT përvojën e fituar. Përveç titujve dhe gradave, një pjesë e pedagogëve disponojnë përvoja trajnimi të certifikuara, duke i bërë ata ndihmues në procesin e përmirësimit të metodave të mësimdhënies, nxënies dhe kultivimit të mendimit kritik, në respekt të lirisë akademike. <i>Megjithatë, siç theksohet në kriterin 2 të këtij standardi rekomandohet hartimi i një manuali të veçantë në departament në lidhje me format e mësimdhënies, të pasuruar nga përvojat dhe propozimet e stafit akademik, si dhe nga propozimet e studentëve.</i> Evidenca: 4.2.1. <i>Plani mësimor sipas modelit të Tabelës 10.</i> 4.3. <i>Programi i lëndëve mësimore në Gjuhën Shqipe.</i> 4.7. <i>Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit.</i> 4.15. <i>CV e personelit akademik dhe ndihmës akademik të angazhuar në programin e studimit.</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	DPPS vlerëson periodikisht performancën e pedagogut për sa i përket përcjelljes së dijes me anën e metodave të mësimdhënies. Për këtë ndihmojnë mendimet e vjelura nga studentët përmes pyetësorëve që organizon NJSBC-ja por edhe diskutimet e lira me studentët dhe përfaqësuesit e tyre në këshillat studentorë. Nga takimet me studentët na u transmetuan vlerësime pozitive për punën e pedagogëve në metodat e mësimdhënies dhe transparencën që ata shfaqin me studentët. Evidenca: 1.6. <i>Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT.</i> 3.6. <i>Rregullore e programit të studimit Master në Administrim i shërbimeve sociale.</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e	UT, FSHS dhe njësitë e NJSBC dhe Karrierës kujdesen për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. Siç u përmend në kriterin 3 të këtij standardi, UT ka çelur Qendrën për Zhvillimin profesional, ku pedagogët mund të trajnohen me aftësi të

vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	mëtejshme të mësimdhënies. Gjithashtu, nevojat për trajnime të mëtejshme shprehen nga përgjegjësi i departamentit në dekanat dhe dekani kujdeset për menaxhimin e kërkesave në fjalë. Evidentimi i problematikave në lidhje me cilësinë e mësimdhënies realizohet nga NJSBC, e cila procedon më pas me komunikimin e autoriteteve përgjegjëse në dekanat. Edhe sektori i karrierës kujdeset për bashkëpunime me institucionet partnere dhe me biznesin, të cilat mund të propozojnë pasurimin e metodave të mësimdhënies, kryesisht në kontekstin e praktikës profesionale. Rekomandohet organizimi i veprimtarive shkencore në lidhje me didaktikën në fushën përkatëse, në bashkëpunim me njësi akademike por edhe me palët e tjera të interesuara. Evidenca: 1.11. Manuali i cilësisë. 1.13. Manuali i vlerësimit të performancës të personelit akademik. 1.14. Paketa e instrumenteve të cilësisë. 1.2. Statuti i UT <https://unitir.edu.al/ep-content/uploads/2019/08/Statuti_2018.pdf> 1.24. Strategjia institucionale për mesimdhënie 2022-2027 1.3. Rregullore e UT <https://unitir.edu.al/rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022/> 1.6. Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT. 1.6.1. Rregullore për organizimin dhe funksionimin e njësive të sigurimit të brendshëm të cilësisë në UT 2022. 2.3. Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Sociale 3.2. Strategjia e zhvillimit të Departamentit 3.5. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit Master Shkencor në 'Administrim i Shërbimeve Sociale' 2020 - 2024 3.6. Rregullore e programit të studimit Master Shkencor 'Administrim i Shërbimeve Sociale -- Qendra për Zhvillimin Profesional në UT <https://unitir.edu.al/qender-virtuale-e-trajnit-dhe-zhvillimit-profesional/>			
Konkluzione	UT garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve. Nisur nga përvoja e rëndësishme e DPPS me metodat e mësimdhënies rekomandohet diskutimi i metodave inovative në veprimtari shkencore të dedikuara, si dhe në kontakt me pedagogë dhe studentë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyra e testimit dhe e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale-shkencore përcaktohen nga dokumentacioni në fuqi i UT dhe njësive përbërëse, si statuti, rregulloret e UT, FSHS, DPPS, ajo e programit të studimit, rregullorja e NJSBC, ku kjo e fundit si njëri mat edhe operacionalizimin e parashikimeve normative në raportet periodike që harton. Kontrolli i dijeve përbëhet nga vlerësimi i vazhduar (detyrat e kursit, esetë, prezantimet, punët në grup) dhe nga provimi përfundimtar. Këto parashikohen paraprakisht në programet lëndore të pedagogut, të miratuara më pas në departament. Evidenca: 1.3. Rregullore e UT <https://unitir.edu.al/rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022/>. 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023. 3.3. Rregullore e Departamentit të Punës dhe Politikës Sociale. 3.6. Rregullore e programit të studimit Master Shkencor ' Administrim i Shërbimeve Sociale. 4.3. Programi i lëndëve mësimore në Gjuhën Shqipe.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive në fillim të çdo moduli, në respekt të programeve lëndore, të rregullores së programit të studimit dhe të dokumentacionit normativ të UT. Kjo na u konfirmua edhe në takimin me studentët të cilët nuk evidentuan problematika apo shqetësime të veçanta. Evidenca: 3.6. Rregullore e programit të studimit Master Shkencor ' Administrim i Shërbimeve Sociale. 4.3. Programi i lëndëve mësimore në Gjuhën Shqipe.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe	Sipas rregullores së UT testimi i dijeve bëhet me shkrim, me gojë ose i kombinuar. Mënyrat dhe format e kontrollit të dijeve përcaktohen nga rregulloret dhe në programet lëndore. DPPS

mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	krijon komisione për mbikqyrjen e procesit të provimeve nëse e vlerësojnë një gjë të tillë. Rekomandohet forma të alternuara të vlerësimit të dijes në pyetje multiple choice. Këtu mund të ndihmojë platforma ClearScore e Albanian-American Development Foundation (AADF) me të cilin UT ka edhe një marrëveshje të veçantë. Evidenca: 1.10.1. Marrëveshje bashkëpunimi midis Albanian-American development foundation. 3.3. Rregullore e Departamentit të Punës dhe Politikës Sociale. 3.6. Rregullore e programit të studimit Master Shkencor 'Administrim i Shërbimeve Sociale'. 4.3. Programi i lëndëve mësimore në Gjuhën Shqipe.			
Konkluzione	Testimi i njohurive dhe dijeve është i përcaktuar tek dokumentacioni normativ i UT dhe njësisë përbërëse të tij. Ai kontrollon nga DPPS dhe nga NJSBC-ja përmes formave të vjeljes së mendimeve të studentëve. DPPS është transparent në informimin e studentëve me format dhe mënyrat e vlerësimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Testimi dhe vlerësimi i njohurive realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet rregulloret e njësisë bazë, përfshirë edhe programet lëndore. Komponentët e vlerësimit në këtë program studimi janë: a) frekuentimi i lëndës, pjesëmarrja aktive, detyra e kursit dhe testi i pjesshëm 40% e pikëve totale; b) provimi përfundimtar 60% e pikëve totale. Evidenca: 2.10. Baza rregullatore për mësimdhënien, të nxënit dhe provimet. 3.12. Forma e kontrollit të njohurive. 4.3. Programi i lëndëve mësimore në Gjuhën Shqipe.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të	UT ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Albanian-American development foundation, e cila vë në dispozicion

testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	platformën elektronike të vlerësimit ClearScore. Nga takimi me stafin akademik na u konfirmua se nuk aplikohen sisteme elektronike të vlerësimit, diçka që përkundrazi do të ishte e <i>rekomandueshme si formë alterantive atje ku ka hapësirë, për arsye të epokës ku ne jetojmë, në të cilën informacioni digjital është bërë pjesë e pandashme për të gjithë ne.</i> Evidenca: 1.10.1. <i>Marrëveshje bashkëpunimi midis Albanian-American development foundation.</i> 2.10. <i>Baza rregullatore për mësimdhënien, të nxënit dhe provimet.</i> 4.3. <i>Programi i lëndëve mësimore në Gjuhën Shqipe.</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me bazën ligjore në fuqi (statutin e UT dhe rregulloret e njësive hierarkike UT – FSHS – DPPS – program studimi), si dhe në respekt të programeve lëndore (silabuseve). Vlerësimi përfundimtar është shumatorja e vlerësimit të vazhduar dhe atij përfundimtar, ku studenti është i informuar paraprakisht për mënyrën e vlerësimit. Nga takimi me studentët u shfaq <i>nevoja që disa prej pedagogëve duhet të njoftojnë paraprakisht pikët e vlerësimit të vazhduar, pasi ka patur raste kur ato janë hedhur në fund të korrigjimit të provimeve dhe në mungesë dijenie nga studentët.</i> Evidenca: 3.6. <i>Rregullore e programit të studimit Master Shkencor ' Administrim i Shërbimeve Sociale.</i> 4.3. <i>Programi i lëndëve mësimore në Gjuhën Shqipe.</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi i vazhduar dhe përfundimtar shoqërohet me komente për identifikimin e gabimeve dhe këshillat e mundshme u konsultohen studentëve në orë të veçanta. Pedagogët kanë orare konsultash me studentët dhe i kanë afishuar ato në zyrat përkatëse. Por nga takimi me pedagogët u evidentua mungesa e kërkimit të konsulencës nga studentët. Gjithashtu, nga studentët u konfirmua korrektësia e pedagogëve në shpjegimin e vlerësimit të vendosur, përveç disa rasteve të izoluara ku vlerësimi i vazhduar nuk u komunikohet paraprakisht studentëve, siç përshkruhet në kriterin e mësipërm.
	Evidenca:

	1.3. Rregullore e UT <https://unitir.edu.al/rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022/>. 3.25. Orare të konsultimit të studentëve. 3.6. Rregullore e programit të studimit Master Shkencor ' Administrim i Shërbimeve Sociale.
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Baza normative e UT parashikon penalitete në raste kopjimi dhe plagjiature, ndërkohë që DPPS përpiqet që t'i shmangë këto forma për të mos kaluar në penalitete. Pedagogët përpiqen që me anën e konsultimeve dhe të studimeve unike të rastit të shmangin plagjiaturën. Megjithatë, rekomandohet blerja dhe aplimi i programeve antiplagjiature në detyrat e kursit dhe në punimet e diplomave. Evidenca: 1.3. Rregullore e UT <https://unitir.edu.al/rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022/>. 3.6. Rregullore e programit të studimit Master Shkencor ' Administrim i Shërbimeve Sociale.
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Vlerësimi i studentëve bazohet në meritë dhe rezultatet dorëzohen në sekretarinë mësimore brenda afatit të përcaktuar prej 8 ditësh. Përpara dorëzimit të procesverbalit me notat përfundimtare pedagogu hedh vlerësimin në platformën elektronike E-Student. Studentët kanë mundësi të shohin dhe të ballafaqojnë notën përpara finalizimit të procesit. Evidenca: 1.3. Rregullore e UT <https://unitir.edu.al/rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022/>. 2.10. Baza rregullatore për mësimdhënien, të nxëniet dhe provimet. 3.6. Rregullore e programit të studimit Master Shkencor ' Administrim i Shërbimeve Sociale.
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studenti ka të drejtën të njihet me vlerësimin dhe të drejtën e ankimit brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve në platformën E-Student. Ata mund të kërkojnë njohjen e tezës së plotësuar të provimit dhe pikëzimin e detajuar. Të gjithë procedurat dhe afatet janë të pasqyruara saktë në rregulloret e IAL-së, me të cilët studentët janë njohur paraprakisht. Evidenca:

	1.3. Rregullore e UT <https://unitir.edu.al/rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022/>. 2.10. Baza rregullatore për mësimdhënien, të nxënit dhe provimet. 3.6. Rregullore e programit të studimit Master Shkencor ' Administrim i Shërbimeve Sociale.			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Në rast ankimimi, studenti paraqet kërkesë me shkrim tek përgjegjësi i departamentit i cili kryen verifikimet e nevojshme dhe në pamundësi informon në mënyrë hierarkike dekanin. Brenda 48 orëve pas marrjes së informacionit nga përgjegjësi i departamentit, dekani ngre një komision të posaçëm që verifikon me detaje pretendimet e studentit. Komisioni cakton edhe vlerësimin përfundimtar të studentit. Nga takimi me studentët na u konfirmua se praktikisht nuk ka patur raste ankimimi dhe se departamenti ka qenë korrekt për mos të patur problematika në lidhje me vlerësimin. Evidenca: 1.3. Rregullore e UT <https://unitir.edu.al/rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022/>. 2.10. Baza rregullatore për mësimdhënien, të nxënit dhe provimet. 3.6. Rregullore e programit të studimit Master Shkencor ' Administrim i Shërbimeve Sociale.			
Konkluzione	DPPS siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit. Përgatitja normative e departamentit për të qenë korrekt me procesin e vlerësimit konfirmohet edhe nga mungesa e precedentëve specifikë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4 Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë	Programi i studimit garanton thellimin e njohurive, të cilat ndihmojnë studentit për të shpjegojë dhe interpretojë në mënyrë profesionale fenomene dhe probleme që lidhen me administrimin





profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	e shërbimeve sociale. Paralelisht, thellimi i njohurive i ndihmon studentët në vazhdimin e ciklit të tretë të studimeve. Programi i studimit garanton gjithashtu zhvillimin e aftësive profesionale, qoftë nëpërmjet orëve praktike (seminare, detyra kursi, kuize) dhe kryesisht nëpërmjet praktikës profesionale. Është pozitive ndarja e praktikës në tre semestra, me qëllim që studenti të jetë në sistematikisht në kontakt me punën në terren. Evidenca: 3.21.1 Tabelë përmbledhëse me trajnime, konkurse, praktika profesionale, intership dhe mundësi punësimi për studentër e diplomuar. 3.6. Rregullore e programit të studimit Master Shkencor ' Administrim i Shërbimeve Sociale'. 4.1. Korniza konceptuale e programit të studimit. 4.2.1. Plani mësimor sipas modelit të Tabelës 10.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit ofron një gamë lëndësh të lidhura ngushtë me administrimin e shërbimeve sociale, me qëllim thellimin e njohurive dhe aftësive profesionale. Megjithatë, <i>ka vend për prezantimin e lëndëve që mund të ndihmojnë në zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit apo edhe dimensionit human, si fusha të rëndësishme në epokën e sotme. Kështu, lënda Metoda të avancuara të kërkimit shkencor (sasior dhe cilësor) mund të bëhej një lëndë e vetme, duke qenë se edhe nga takimi me studentët u vu në dukje përsëritja e metodave të kërkimit në raport me programet bachelor.</i> Evidenca: 3.6. Rregullore e programit të studimit Master Shkencor ' Administrim i Shërbimeve Sociale'. 4.1. Korniza konceptuale e programit të studimit. 4.2.1. Plani mësimor sipas modelit të Tabelës 10.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre,	Në takimin e stafin akademik dhe me studentët na u konfirmua se në përfundim të çdo lënde pedagogët mbledhin të dhënat, i analizojnë dhe i shqyrtojnë, për sa i përket kompetencave dhe aftësive që fiton studenti, në harmoni me planin mësimor dhe programet lëndore të miratuara nga departamenti. <i>Rekomandohet dokumentacion verifikues, si për shembull analiza e vlerësimit në përfundim të një lënde.</i> Gjithashtu, shqyrtimi i arritjes së kompetencave është objekt i analizave periodike në departament si dhe të NJSBC-së.

si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Evidenca: 3.12. <i>Format e kontrollit të njohurive (Tabela 15).</i> 3.18 <i>Raport vjetor i DPPS 2022-2024.</i> 4.3 <i>Programi i lëndëve mësimore në Gjuhën Shqipe.</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Programi i studimit synon që mësimdhënien ta realizojë në bazë kompetencash, me qëllim zhvillimin e njohurive të marra në praktikat profesionale. Në këtë aspekt, motivohen studimet e rastit dhe politikat sociale në nivele të ndryshme - kombëtar, komunitar dhe familjar. Gjithashtu, studentët motivohen të ndërmarrin dhe të prezantojnë punë (detyra) në grup. Nëpërmjet këtyre të dyjave metodave, studenti vendoset në qendër të mësimdhënies dhe inkurajohet fryma e bashkëpunimit në menaxhimin e problematikave sociale. Evidenca: 1.24. <i>Strategjia institucionale per mesimdhënien 2022-2027 vendim-nr.24.</i> 2.10. <i>Baza rregullatore për mësimdhënien, të nxënit dhe provimet.</i> 3.18 <i>Raport vjetor i DPPS 2022-2024.</i> 3.22 <i>Politika për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.</i> 3.23 <i>Raport i anketimit mbi kënaqësinë e studentëve për cilësinë e mësimdhënies në FSHS, UT viti akademik semestri I, 2022 - 2023.</i> 4.3 <i>Programi i lëndëve mësimore në Gjuhën Shqipe.</i> 4.7. <i>Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit (Tabela 6).</i>
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	DPPS dhe koordinatori i programit të studimit inkurajojnë stafin PAE dhe PAK të organizojnë orë të hapura, ku të diskutohen tematika aktuale që lidhen me fushën e studimit dhe konkretisht veçantësitë e shoqërisë shqiptare, përfshirë edhe dimensionet kryesore që karakterizojnë sot shoqëritë nën efektin e Globalizmit. Në tabelën bashkangjitur evidentohen se janë organizuar rreth 5 leksione të hapura për periudhën 2022-2024. Evidenca: 3.24. <i>Dosje e leksioneve, aktiviteteve, konferencave të hapura.</i>
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	DPPS së bashku me stafin akademik nxisin studentët për zhvillimin e ideve novative dhe studimeve të përparuara kërkimore-shkencore. Kjo realizohet përmes punimeve të diplomës nën udhëheqjen e pedagogut si dhe aksesit nëpër projekte dhe në konferencat shkencore.

	DPPS apo edhe FSHS mund të organizojnë një ditë/javë të caktuar vjetore (panair) ku studentët të ofrojnë ide inovative, ku të parashikohen shpërblime motivuese. Evidenca: 1.18. Vendim BA Për miratimin e programit të Grantit për konferenca ndërkombëtare. 2.10. Baza rregullatore për mësimdhënien, të nxëniet dhe provimet. 2.11. Rregullore e Diplomimit FSHS. 3.2.1. Strategjia e kërkimit shkencor për Departamentin e Punës dhe Politikës Sociale 2020 - 2024. 3.24. Dosje e leksioneve, aktiviteteve, konferencave të hapura.			
Konkluzione	Programi i studimit garanton thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale tek studentët. PAE organizojnë orë të hapura, ku të diskutohen tematika aktuale që lidhen me fushën e studimit dhe konkretisht veçantësitë e shoqërisë shqiptare. Rekomandohet pasurim i kurrikulës me njohuri specifike që karakterizojnë shoqëritë bashkëkohore, si dhe vjelja e ideve inovative nga studentët.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Detyrimi përmbyllës i këtij programi studimi sipas rregullores së FSHS (neni 56) është punimi i temës së diplomës, e cila mbrohet pas shlyerjes së të gjitha detyrimeve që parashikon plani mësimor, para një jurie të posaçme, të propozuar nga përgjegjësi i departamentit dhe të miratuar nga dekani. Evidenca: 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023. 2.11. Rregullore e Diplomimit FSHS. 3.6. Rregullore e programit të studimit Master Shkencor ' Administrim i Shërbimeve Sociale'.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion	Studentëve u vihet paraprakisht në dispozicion informacione dhe udhëzime të nevojshme në lidhje me punimin e diplomës, të cilat gjenden kryesisht në Rregulloren për diplomimin dhe në Manualin e punimit të diplomës, e cila rekomandohet t'i

informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	<i>bashkangjitet dokumentacionit në rast se ekziston. GVJ nuk arriti ta verifikojë këtë manual tek dokumentat e dorezuar.</i> DPPS dhe stafi akademik asistojnë studentët në procesin e saktësimit të temës përfundimtare dhe udhëheqjen e tij/saj përgjatë të gjithë hulumtimit shkencor. Evidenca: 2.11. Rregullore e Diplomimit FSHS. 3.6. Rregullore e programit të studimit Master Shkencor 'Administrim i Shërbimeve Sociale'.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Ky standard nuk lidhet me programin e studimit, pasi ky i fundit parashikon vetëm punim diplome si detyrim përmbyllës. Kriteri në RVB është plotësuar gabimisht.
Kriteri 4. Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Përzgjedhja e temave bëhet nga studentët sipas grup-temave të sugjeruara nga DPPS dhe miratohet nga ky i fundit. Pas miratimit të temës, pedagogu udhëheqës asiston studentin përgjatë gjithë hulumtimit shkencor dhe e monitoron atë, sipas standardeve më të larta të kërkimit shkencor. Në përfundim të studimit të temës, udhëheqësi duhet të japë dakordësinë e tij përpara se të procedohet me mbrojtjen e temës. Siç theksohet në kriterin 5 të standardit III.3. rekomandohet blerja dhe aplimi i programeve antiplagjiature në punimet e diplomave. Evidenca: 2.11. Rregullore e Diplomimit FSHS. 3.6. Rregullore e programit të studimit Master Shkencor 'Administrim i Shërbimeve Sociale'.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Në punimin e diplomës dhe konkretisht përgjatë hulumtimit shkencor DPPS drejton studentët në ambientet e bibliotekës së FSHS e cila ka një fond modest të literaturës së fundit dhe asaj klasike që lidhen me shkencat sociale. Evidenca: 2.11. Rregullore e Diplomimit FSHS. 2.24. Rregullore e Bibliotekës 2019.



	2.26. Buxheti për pasurim të bibliotekës. 2.27. Dokument mbi librat e fundit për bibliotekën. 3.6. Rregullore e programit të studimit Master Shkencor ' Administrim i Shërbimeve Sociale. 3.9. Botime librash nga Departamentit të Punës dhe Politikës Sociale. 4.10. Të dhëna për burimet e literaturës për programin e studimit që ofrohen nga Biblioteka e FSHS.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Sipas rregullores së FSHS, DPPS dhe programit të studimit, studenti vlerësohet me notë 5-10 nëse cilësohet kalues pas mbrojtjes së temës së diplomës përpara jurisë së posaçme. Nota pasqyrohet në procesverbalin përkatës, i cili firmoset dhe dorëzohet në sekretarinë mësimore sipas procedurave në fuqi. Evidenca: 2.9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore 2018. 2.11. Rregullore e Diplomimit FSHS.
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Sipas parashikimeve normative të UT (statutit dhe rregulloreve), studenti pajiset me diplomën dhe me suplementin e diplomës, të miratuara nga MAS. Diploma dhe suplementi përshkruajnë nielin, përmbajtjen, rezultatet e studimeve të kryera dhe të përmbyllura me sukses nga mjetësi i diplomës. Evidenca: 3.6. Rregullore e programit të studimit Master Shkencor ' Administrim i Shërbimeve Sociale. 3.10. Modeli i suplementit të diplomës.
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Sekretaria mësimore e FSHS ruan dokumentacionin e studentit në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ajo mban regjistër bazë të studentëve me të dhënat personale të tyre, vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, të dhëna mbi diplomën së bashku me suplementin e diplomës, të formatuara këto sipas standardeve shtetërore të Republikës së Shqipërisë. Regjistri i studentëve plotësohet në formë të shkruar dhe elektronike dhe mbahet në ruajtje të përhershme. Sekretaria mësimore e departamentit përpilon, administron dhe është përgjegjëse për mirëmbajtjen e regjistrit themeltar (bazë), të shkruar me dorë dhe me kompjuter. Regjistri themeltar plotësohet me shkrim, pa korigjime dhe nuk ndryshohet për asnjë arsye. Përdorimi dhe përpunimi i të dhënave personale të studentëve bëhet prej sekretarisë mësimore në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të

	dhënave personale. Këto dokumente si dhe procesverbalet e provimit, ruhen pas diplomimit, në arkivën e institucionit dhe më pas sipas ligjit për arkivat. Të dhënat origjinale të studentit i kthehen atij, ndërsa institucioni ruan kopje të njësuar me origjinalin në formë hardcopy dhe elektronike. Evidenca: 1.2. Statuti i UT <https://unitir.edu.al/ep-content/uploads/2019/08/Statuti_2018.pdf> 2.9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore 2018.			
Konkluzione	<i>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm. Në përfundim, Të dhënat origjinale të studentit i kthehen atij, ndërsa institucioni ruan kopje të njësuar me origjinalin në formë hardcopy dhe elektronike. Rekomandohet shkrimi i manualit të diplomës në nivel departamenti si dhe kontrolli i diplomave përmes programit antiplagjiaturë.</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Ky standard i referohet programit të studimit “Master profesional” dhe nuk i takon programit të studimit “Administrim i shërbimeve sociale” i cili është “Master shkencor”. Në RVB kriteri është plotësuar gabimisht.
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim	Ky standard i referohet programit të studimit “Master profesional” dhe nuk i takon programit të studimit “Administrim i shërbimeve sociale” i cili është “Master shkencor”. Në RVB kriteri është plotësuar gabimisht.

përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.				
Kriteri 3. Praktikë profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Ky standard i referohet programit të studimit “Master profesional” dhe nuk i takon programit të studimit “Administrim i shërbimeve sociale” i cili është “Master shkencor”. Në RVB kriteri është plotësuar gabimisht.			
Konkluzione	-			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
	-	-	-	-

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1 Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe kualifikimin e duhur të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në	Personeli akademik efektiv dhe me kontratë që angazhohet në këtë program studimi përbëhet si më poshtë: - 2022-2023, 14 PAE (1 Prof. Dr., 9 Prof. As., 3 Dr., 1 Msc) dhe 7 PAK (3 Dr., 4 Msc); - 2023-2024, 13 PAE (1 Prof. Dr., 8 Prof. As., 3 Dr., 1 Msc) dhe 7 PAK (3 Dr., 4 Msc); Sa i përket profilit të stafit akademik PAE dhe PAK, i cili është i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi, pas

mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	shqyrtimit të profilit të stafit dhe ngarkesës mësimore, rezulton se ai është plotësisht në përputhje me profilin e lëndëve që mbulon. Nisur nga fakti se të gjithë anëtarët PAK të stafit akademik të departamentit vijnë nga institucione publike qendrore, vendore apo organizata të ndryshme me profil në shkencat sociale, kjo shihet edhe si një mundësi e mirë për forcimin e lidhjes mes Fakultetit, Departamentit dhe, në veçanti, programit të studimit me tregun e punës. Gjithashtu, kjo ndikon pozitivisht në rritjen e mundësive për praktika profesionale për studentët aktualë dhe në përmirësimin e perspektivave të punësimit për të diplomuarit. Pjesa më e madhe e stafit PAK janë ish-studentë të këtij fakulteti. Evidenca: <i>Evidenca 4.12 Të dhena për shtafin akademik PAE dhe PAK</i> <i>Evidenca 4.15. CV e personelit akademik dhe ndihmësakademik për programin e studimit, 4.6 Veprimtaria kërkimore në nivel programi)</i>
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Ngarkesa mësimore e stafit akademik të departamentit, i cili është i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit “Administrim i Shërbimeve Sociale”, është e shpërndarë në tre komponentët kryesorë: realizimin e procesit mësimor, kërkimin shkencor dhe transferimin e dijeve, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe Udhëzimin e MASR Nr. 29, datë 10.09.2018. <i>Gjithsesi, GVJ nuk arriti të gjejë evidenca rreth ngarkesës që mbulon secila kategori dhe për pasojë nuk mund të shprehet.</i> Evidenca: <i>4.12 Të dhena për shtafin akademik PAE dhe PAK</i> <i>Evidenca 4.15. CV e personelit akademik dhe ndihmësakademik për programin e studimit,</i> <i>Evidenca 4.6 Veprimtaria kërkimore në nivel programi)</i> <i>Evidenca: 1.2 Statuti i Universitetit të Tiranës, 2018, neni 67-70</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e	Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Shkencave Sociale garantojnë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit gjatë gjithë periudhës së akreditimit, duke siguruar kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore e shëndetësore. Për punësimin e stafit akademik efektiv në Departamentin e Punës dhe Politikës Sociale, Fakulteti i Shkencave Sociale vepron në përputhje me statutin e Universitetit

punësimi dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	të Tiranës, duke respektuar periudhën e akreditimit dhe programin e studimit Master Shkencor “Administrimi i Shërbimeve Sociale”, si dhe duke zbatuar procedurat sipas bazës ligjore në fuqi. Universiteti i Tiranës respekton me rigorozitet kuadrin ligjor për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Gjithashtu, UT-ja paguan të gjitha detyrimet si punëdhënëse për çdo kategori të stafit dhe derdh kontributet për sigurimin suplementar për stafin në kategorinë profesor. Evidenca: 1.2 Statuti i Universitetit të Tiranës, 2018, neni 67-70
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Rekrutimi i personelit akademik, si me kohë të plotë ashtu edhe me kohë të pjesshme, realizohet në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Kodin e Punës, statutin, rregulloren dhe manualin e punësimit të UT-së. Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale vepron në përputhje me kriteret e përcaktuara në statutin e Universitetit të Tiranës, duke ndjekur procedurat për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit akademik. Kriteret specifike, të përcaktuara në statut, propozohen nga departamenti bazuar në nevojat akademike dhe kërkimore të programit Master Shkencor “Administrim i Shërbimeve Sociale”. Bazuar në nevojat akademike, DPPS publikon kriteret e përgjithshme dhe të veçanta në fillim të vitit akademik për pedagogët joefektivë dhe, në raste specifike, për rekrutimin e stafit efektiv, sipas procedurave ligjore. Zyra e Burimeve Njerëzore e FSHS administron dhe përditëson dosjet e personelit akademik, duke përfshirë dokumentacionin e nevojshëm për stafin me kohë të plotë, të pjesshme apo të ftuar. Evidenca: 1.2 Statuti i Universitetit të Tiranës, 2018; Evidenca: 1.12 Manuali për punësimin e personelit në UT, Evidenca 3.17. Procedurë punësimi nga departamenti)
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e	Plani mësimor i programit të studimit Master Shkencor “Administrim i Shërbimeve Sociale”, i ofruar nga Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale, nuk kërkon laboratorë apo pajisje specifike për realizimin e tij. Kjo pasqyrohet edhe në strukturën e programit, i cili përmban leksione, seminare dhe praktikë, pa

mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	përfshirë laboratorë, duke qenë se kjo nuk përputhet me natyrën e tij. Evidenca: <i>4.2 Plani i miratuar mësimor i programit të studimit.</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Sektori i Burimeve Njerëzore pranë Fakultetit të Shkencave Sociale mbledh, ruan dhe përditëson të dhënat e personelit akademik dhe atij administrativ, duke iu referuar kërkesave ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale. Gjithashtu, veprimtaria e tij është në përputhje me rregulloren e Universitetit të Tiranës për “Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurimin e të Dhënave Personale në Universitetin e Tiranës”. Evidenca: <i>1.8 Rregullorja e Universitetit të Tiranës për “Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurimin e të Dhënave Personale në Universitetin e Tiranës”.</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Fakulteti i Shkencave Sociale ka një numër marrëveshesh bashkëpunimi me institucione qendrore, vendore dhe organizata të ndryshme që operojnë në fushën e shërbimeve sociale. Këto marrëveshje shërbejnë si bazë për kryerjen e praktikave profesionale nga studentët e programit Master Shkencor “Administrim i Shërbimeve Sociale”. Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale disponon mjedise të përshtatshme për realizimin e lëndës së praktikave profesionale. Profili i këtij programi kërkon që studentët të zhvillojnë praktikën pranë shërbimeve sociale në nivel qendror, lokal apo në institucione të tjera përkatëse. Për mbështetjen e këtij procesi, Departamenti angazhon gjashtë anëtarë të personelit akademik, pedagogë të kualifikuar dhe të dedikuar për mbarëvajtjen e praktikave profesionale. Studentët që zgjedhin të mbrojnë diplomën me një tezë kërkimore, Departamenti u ofron një listë lektorësh të cilët ndihmojnë në udhëheqjen dhe mbështetjen e procesit kërkimor. Evidenca: <i>Evidenca: 3.19. Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve;</i>

	<i>Evidenca 3.21. Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese në rang programi studimi për praktikën profesionale)</i>			
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Sipas parashikimeve të Manualit të Praktikës Profesionale, personeli mbikqyrës asiston studentët e programit “Master Shkencor” në “Administrimin e Shërbimeve Sociale” në përmbushjen e detyrimeve të praktikës. Për këtë qëllim, ekziston edhe një format vlerësimi për praktikën e studentëve, i strukturuar me seksione të dedikuara për plotësim nga mbikëqyrësi. Gjithashtu, në Marrëveshjet e Bashkëpunimit përcaktohet se institucioni pritës duhet të sigurojë një mbikëqyrës që supervizon studentët. Evidenca: <i>4.4 Manuali i Praktikës Profesionale për programin e studimit</i>			
Konkluzione	<i>Stafi akademik është në përputhje me parashikimet e Ligjit 8015/2015 dhe në përputhje me profilin e lëndëve përkatëse. Institucioni garanton qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit. Institucioni ka marrëveshje me institucionet qendrore, vendore dhe organizatat që ofrojnë shërbime sociale dhe që i shërbejnë programit të studimit për realizimin e praktikave, nëpërmjet asistimit të studentëve me personel si dhe ofrimin e mjediseve të duhura për realizimin e tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të	Ambjentet e disponueshme për programin e studimit janë të mjaftueshme në raport me numrin e studentëve dhe për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve. Çdo klasë leksioni dhe seminari është e pajisur me Smart Ëhiteboard, videoprojektor dhe instalimet përkatëse, si dhe me sistem ajrimi dhe kondicionimi, duke ofruar kushte komode për zhvillimin e mësimin për studentët dhe stafin. Në ndërtesën e FSHS-së, DPPS-ja ka në shfrytëzim ambiente leksioni dhe seminari, ku zhvillohet mësimi në programin përkatës gjatë orëve të pasdites (14:00-20:00). Salla për realizimin e

studimit dhe moduleve përkatëse.	konferencave, e pajisur me videoprojektor, ndodhet në katin e parë, ndërsa amfiteatri ndodhet gjithashtu në të njëjtin kat. Për nevojat e stafit, shërben gjithashtu një klasë për realizimin e aktiviteteve doktorale, e pajisur me mjetet përkatëse, në katin e dytë. Evidenca: 2.28 Të dhëna për infrastrukturën, Tabela 16 Mjediset e Fakultetit të shkencave Sociale /Njësive Bazë
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Të gjitha klasat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me videoprojektorë. Çdo pedagog i angazhuar në programin Master Shkencor ka në dispozicion një laptop, kompjuter statik, printer dhe mjedise të përshtatshme për punë dhe për ruajtjen e materialeve dhe dokumentacionit të nevojshëm për mësimdhënien. Pajisjet kompjuterike në ndërtesë janë të lidhura me linjë interneti dhe e gjithë ndërtesa ka akses në rrjetin EëFi. Në katin e parë, studentët kanë një mjedis të dedikuar për pushim, punë dhe diskutime. Mjediset e sekretarisë së departamentit dhe sekretarisë mësimore janë të pajisura me teknologjinë e nevojshme për mbështetje të proceseve të mësimdhënies, regjistrimit dhe administratës së studentëve, si dhe për prodhimin e dokumentacionit dhe menaxhimin e bazës së të dhënave. Në korridoret e ndërtesës janë të instaluar ekrane, ku shfaqen informacione të rëndësishme dhe bazike për studentët dhe stafin, përfshirë njoftime, orarin mësimor, aktivitete shkencore, konferenca, trajnime, leksione të hapura, promovime tekstesh dhe informacione zyrtare. Evidenca: 2.28 Të dhëna për infrastrukturën, Tabela 16 Mjediset e Fakultetit të Shkencave Sociale / Njësive Bazë.
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave	Mjediset e disponueshme për programin e studimit Master Shkencor "Administrimi i Shërbimeve Sociale" janë të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme dhe të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, si dhe për zhvillimin e aftësive teorike dhe praktike, duke mundësuar realizimin e objektivave formuese të programit të studimit. Çdo klasë është e pajisur për të mundësuar lidhjen teknologjike të kompjuterëve personalë ose laptopëve me videoprojektorin. Klasat ofrojnë akustikë të shkëlqyer dhe komoditet të mjaftueshëm për zhvillimin e orës mësimore. Arkitektura e klasave është e dizajnuar për të mbështetur metodat

formues të programit të studimit në tërësi.	bashkëkohore të mësimdhënies, duke marrë parasysh specifikat e lëndëve të caktuara, që kërkojnë riorganizimin e hapësirës për t'u përshtatur me metodologjinë dhe didaktikën e mësimdhënies. Kjo përfshin, ndër të tjera, vendosjen e ndenjësve në formë rrethore, ndarjen e studentëve në grupe për punë, përdorimin e videove me ndriçim të reduktuar, dhe metodat e tjera inovative për të pasuruar procesin e mësimdhënies. Evidenca: 2.28 Të dhëna për infrastrukturën, Tabela 16 Mjediset e Fakultetit të shkencave Sociale /Njësive Bazë;
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Në bibliotekën e Fakultetit të Shkencave Sociale ofrohen poste studimi për literaturën, pajisje të teknologjisë së informacionit, të cilat janë të pajisura me akses në programe profesionale si SPSS, si dhe akses në biblioteka dhe librari digjitale. Studentët kanë gjithashtu mundësi të aksesojnë revista shkencore të profilizuara sipas programeve të studimit, përfshirë programin Master Shkencor “Administrimi i Shërbimeve Sociale”. Biblioteka ofron një ambient të dedikuar për studim, të pajisur me kompjuterë dhe akses në internet, si dhe mundësinë për të shfrytëzuar disa biblioteka elektronike, si J-Store dhe të tjera. Biblioteka është pasuruar me tituj të rinj, dhe në buxhet janë planifikuar fonde për pasurimin e mëtejshëm të saj. Këto poste kompjuterash të instaluar në ambjentet e bibliotekës të cilat ofrojnë dhe softëare të përshtatshëm për kërkim shkencor nga studentet e Masterit Shkencor “Administrimi i Shërbimeve Sociale”, konsiderohen dhe si laborator i TI. <i>GVJ sugjeron që të instalohet një laborator i dedikuar i paisur me të gjithë infrastrukturën e duhur për ti ardhur në ndihmë studenteve dhe stafit në drejtim të kërkimit shkencor.</i> Evidenca: 2.28 Të dhëna për infrastrukturën, Tabela 16 Mjediset e Fakultetit të shkencave Sociale /Njësive Bazë; Evidenca: 2.25 Të dhëna për bibliotekën; Evidenca: 2.26 Buxhetimi për pasurim të bibliotekës)
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar	FSHS ka një sërë marrëveshjesh me një numër institucionesh qendrore, vendore dhe organizatash që ofrojnë shërbime sociale. Janë 18 marrëveshje, të cilat mundësojnë zhvillimin e praktikave për studentët e FSHS dhe të programit të studimit Master Shkencor “Administrimi i Shërbimeve Sociale”. Po ashtu, ekzistojnë 9



nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	marrëveshje në nivel universiteti me ministri, drejtoritë e përgjithshme, autoritete shtetërore dhe universitete të tjera, të cilat rrisin mundësitë për zhvillimin e praktikave. Në këto institucione, përfshihen studentët që kryejnë praktikat pranë institucioneve të caktuara arsimore ose shëndetësore. Studentët ndiqen dhe monitorohen nga pedagogu i praktikës, personeli i institucionit ose nga stafi akademik me kohë të pjesshme, i angazhuar për ndjekjen e praktikave mësimore. Evidenca: <i>2.4 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023; Evidenca: 4.1. Korniza Konceptuale e programit të studimit; Evidenca: 4.2. Plani i miratuar mësimor i programit të studimit; Evidenca: 3.19. Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve; Evidenca: 3.21. Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese në rang programi studimi për praktikat profesionale)</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni siguron mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, të pajisura me teknologji dhe që garantojnë zhvillimin cilësor të procesit mësimor. Biblioteka ofron poste studimi për literaturën, pajisje të teknologjisë së informacionit, të cilat janë të pajisura me akses në programe profesionale si SPSS, si dhe akses në biblioteka dhe librari digjitale. Institucioni ka marrëveshje me institucione qendrore, lokale dhe organizata të ndryshme që ofrojnë shërbime sociale për garantimin e praktikave për studentët e programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në	Biblioteka e fakultetit përmban të gjitha tekstet e nevojshme për studentët dhe ofron akses në librari digjitale, ku mund të gjendet literatura bazë dhe ndihmëse e përcaktuar në syllabus-in e çdo

gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	lënde të programit të studimit. Kjo literaturë është kryesisht në gjuhën shqipe, por përfshin edhe materiale në anglisht. Profesorët e programit “Master Shkencor në Administrimin e Shërbimeve Sociale” sigurojnë që studentët të kenë qasje të plotë në literaturën bazë dhe ndihmëse, si në gjuhën shqipe ashtu edhe në atë të huaj. Kjo realizohet përmes: • Teksteve mësimore të përkthyer nga shtëpi botuese • Teksteve të hartuara nga stafi akademik • Teksteve të përkthyer në kuadër të projektit CleanScore të AADF • Monografive dhe teksteve të botuara nga pedagogët e fakultetit • Revistave në format fizik në gjuhën shqipe dhe të huaj, si dhe revistave të DPPS Përveç këtyre burimeve, DPPS ka punuar për krijimin e një baze tekstesh të përgatitura nga pedagogët e departamentit. Edhe pse departamenti është krijuar prej pak kohësh, është arritur të mbulohet rreth 80% e lëndëve bazë të kurrikulës me tekste në gjuhën shqipe. Evidenca: <i>4.3 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit; Evidenca: 4.10. Të dhënat për burimet e literaturës për programin e e studimit që ofron Biblioteka e FSHS. Lista e teksteve/periodeke në bibliotekë (hard/e-book dhe të shtuar në vite) në funksion të programit të studimit;</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Nga vëzhgimi i programeve mësimore (syllabuseve) rezulton se stafi akademik i angazhuar pranë DPPS, në përgjithësi, e rifreskon periodikisht literaturën bazë sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe në funksion të lëndës. <i>Gjithsesi, në disa raste vërehen programe mësimore të pa-përditësuara me literaturën e pesë viteve të fundit.</i> Evidenca: <i>4.3 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit;</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke	Fakulteti i Shkencave Sociale disponon një bibliotekë të pasur me tituj librash nga fusha të ndryshme të programeve të studimit që ofron, duke përfshirë edhe Masterin Shkencor në Administrimin e

garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Punëve Sociale. Studentët e këtij fakulteti kanë mundësi të shfrytëzojnë bibliotekën në mënyrë të barabartë, në një orar të përshtatshëm për mësimnxënie, nga ora 08:00 deri në 18:00, si dhe të kenë akses në burimet digjitale.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka e Fakultetit të Shkencave Sociale (FSHS) disponon një fond të pasur librash fizikë, duke përfshirë tekste mësimore dhe literaturë në gjuhën shqipe, angleze, frënge, italiane dhe gjuhë të tjera. Po ashtu, biblioteka ofron qasje në revista shkencore të ndryshme, të cilat mbulojnë fushat e programeve të studimit të ofruara nga ana e FSHS. Evidenca: <i>Evidenca: 2.25 Të dhëna për bibliotekën;</i> <i>Evidenca: 2.26 Buxheti për pasurim të bibliotekës;</i> <i>Evidenca: 2.27 Dokument mbi librat e fundit për bibliotekën</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Biblioteka e Fakultetit të Shkencave Sociale (FSHS) disponon një fond të pasur librash fizikë, duke përfshirë tekste mësimore dhe literaturë në gjuhën shqipe, angleze, frënge, italiane dhe gjuhë të tjera. Po ashtu, biblioteka ofron qasje në revista shkencore të ndryshme, të cilat mbulojnë fushat e programeve të studimit të ofruara nga ky fakultet. Të gjitha punimet shkencore të studentëve, përfshirë tezat e masterit shkencor dhe doktoraturës, janë të aksesueshme përmes kompjuterëve të bibliotekës. Universiteti i Tiranës dhe FSHS, me mbështetjen e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MASR), kanë siguruar shërbimin e bibliotekës online për stafin akademik dhe studentët. Në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF), Universiteti i Tiranës ka përfunduar marrëveshjen për abonimin në bibliotekën digjitale JSTOR, duke mundësuar akses të drejtpërdrejtë në këtë platformë nga të gjitha godinat dhe rrjeti i UT-së. Gjithashtu, personeli akademik dhe studentët mund të aksesojnë libraritë online përmes platformës ULIBRARY (https://ulibrary.rash.al) dhe manualit përkatës (https://ulibrary.rash.al/manual.pdf). Kjo platformë ofron

	mundësinë e eksplorimit të materialeve të lidhura me programet e studimit, sipas udhëzimeve të manualit. Ky shërbim ofrohet falas për studentët dhe stafin akademik. Përditësimi dhe digjitalizimi i katalogut bibliografik • Përmes softuerit Cobib.al, biblioteka përditëson vazhdimisht tekstet dhe artikujt shkencorë si pjesë e rrjetit ndërkombëtar Cobis.Net (ëëë.cobis.net). • Studentët mund të kërkojnë materiale dhe artikuj digjitalë duke ndjekur udhëzimet e manualit të bibliotekës digjitale në këtë link: https://ulibrary.rash.al. Projekti ERA 2012 dhe burimet elektronike për Shqipërinë Biblioteka elektronike online është zhvilluar në kuadër të projektit Electronic Resources for Albania (ERA2012), mbështetur nga IZUM (Qendra Rajonale për Sistemet e Informimit Bibliotekar dhe Sistemet e Informacionit Kërkimor), EIFL (Electronic Information for Libraries) dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Në këtë kuadër, studentët dhe pedagogët kanë akses në literaturë dhe materiale shkencore me tekst të plotë nga platformat: • E-library Academic Complete • EBSCO Academic Search Premier • Emerald Management e Journal Collection • Multi-Science Journals Collection • ProQuest Central • Taylor & Francis Library, dhe shumë të tjera. Evidenca: 2.25.2 Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj (Tabela 17); 1.10.1 Marrëveshje bashkëpunimi midis Albanian-American development foundation dhe Universitetit të Tiranës për shtrirjen e projektit "Clean Score: cilësia e materialeve mësimore dhe vlerësimi i performancës së studentëve)
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të	Biblioteka e FSHS është e pajisur me kompjuterë në dispozicion të studentëve, për të aksesuar të gjitha bibliotekat online ku janë të abonuar UT dhe FSHS.

tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Për më tepër, biblioteka ka krijuar një katalog të rekordeve online dhe është bërë pjesë e platformës COBISS , duke i ofruar studentëve dhe stafit akademik akses të lehtë dhe të shpejtë nga çdo vendndodhje.
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka e FSHS është e hapur për studentët nga ora 08:00 deri në 18:00, duke u përshtatur me oraret e procesit mësimor dhe duke ofruar shërbim edhe përtej tyre, në varësi të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. Informacioni mbi orarin e funksionimit ishte i publikuar qartë në ambientet e bibliotekës ashtu edhe në faqen zyrtare të fakultetit (e cila në momentin e vizitës ne. Evidenca: <i>2.24 Rregullore e Bibliotekës</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Biblioteka nëpërmjet personelit të bibliotekës mban regjistër të plotë të abonimeve dhe përdoruesve të bibliotekës duke i paisur ato me kartë anëtarësimi. Njëkohësisht ndjek përditësimin dhe shfrytëzueshmërinë fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik, nëpërmjet prezencës dhe kërkesës fizike dhe kërkesës për aksesimin online. Evidenca: <i>4.10. Të dhënat për burimet e literaturës për programin e e studimit që ofron Biblioteka e FSHS. Lista e teksteve/periodike në bibliotekë (hard/e-book dhe të shtuar në vite) në funksion të programit të studimit;</i> <i>2.32 Dokument mbi librat e fundit për bibliotekën https://unitir.edu.al/biblioteka-online/.)</i>
Konkluzione	<i>Literatura bazë dhe ndihmëse garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara nga programi i studimit. Literatura, në përgjithësi, përditësohet rregullisht. Biblioteka ka një fond të kënaqshëm librash fizikë si dhe ofron mundësinë e aksesit në disa biblioteka online, duke rritur mundësinë e studentëve dhe stafit për të shfrytëzuar më shumë literaturë. Ambientet e bibliotekës janë të hapura në orare të përshtatshme</i>



	dhe ofrojnë gjithashtu një sallë të pajisur me kompjuterë për aksesimin e bibliotekave online. Personeli i bibliotekës ndjek cilësinë e fondit dhe monitoron përdorimin e bibliotekës nga stafi dhe studentët.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Sekretariati i FSHS-së mban regjistrat në formë të shkruar, si më poshtë: - Regjistrin themeltar të studentëve, - Regjistrin e arritjeve akademike, që përfshin gjithashtu procesverbalin e çdo provimi ose detyrimi tjetër akademik, - Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe çertifikatave. Sekretariate mësimore të departamenteve plotësojnë këto regjistra edhe në formë elektronike. <i>Regjistri i arritjeve akademike nuk është zëvendësuar me formatin e ri të ardhur nga QSHA. GJV rekomandon marrjen e masave për plotësimin me rregjistrat e duhur.</i> Në UT/FSHS funksionon Sektori i IT-së dhe Sistemi kompjuterik, i cili është një sistem modular që operon mbi bazën e moduleve të ndryshme. Përdorimi i sistemit është i rregulluar me anë të një manuali. Përmes sistemit, studentët mund të regjistrojnë orarin, lëndët semestrale, tërheqin vërtetime notash, si dhe shërbime të tjera. Fakulteti i Shkencave Sociale ka krijuar një procedurë sistematike për menaxhimin e informacionit lidhur me studentët dhe aktivitetet e tyre, nga regjistrimi deri në diplomim, përmes sekretarisë mësimore për programin e studimit Master. Të dhënat administrohen në mënyrë elektronike dhe në kopje fizike përmes regjistrave.

	Evidenca: <i>1.3 Rregullore e Universitetit të Tiranës, 2022;</i> <i>2.9 Rregullore e sekretarisë mësimore;</i> <i>1.10 Manual perdorimi i sistemit informatik e-student 2022</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	UT/FSHS disponon një sistem të brendshëm për administrimin e informacionit, dokumentacionit dhe aktiviteteve të personelit akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ, i cili funksionon në përputhje me ligjin për ruajtjen e privatësisë dhe rregulloren e Universitetit të Tiranës për “Mbrotjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurimin e të Dhënave Personale”. Aksesit në informacionet dhe dokumentet për personelin dhe studentët e programit të studimit është përcaktuar procedurialisht dhe është i shprehur gjithashtu në Programin e Transparencës për Universitetin e Tiranës. Evidenca: <i>1.8 Rregullore e Universitetit të Tiranës për “Mbrotjen, Përpunimin, ruajtjen dhe sigurimin e të dhënave personale në Universitetin e Tiranës</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi kompjuterik i Universitetit të Tiranës siguron akses të dedikuar në informacion dhe dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. Në përputhje me nevojat, sistemi mundëson dhe gjeneron raporte statistikore lidhur me ecurinë akademike të studentëve, pagesën e tarifës së studimit, etj. Studentët dhe stafi akademik mund të aksesojnë informacionin përmes kërkesave zyrtare, të administruara, për ato të dhëna që nuk janë të rregulluara nga rregullorja e të dhënave personale. Evidenca: <i>1.8 Rregullore e Universitetit të Tiranës për “Mbrotjen, Përpunimin, ruajtjen dhe sigurimin e të dhënave personale në Universitetin e Tiranës;</i> <i>1.10 Manual perdorimi i sistemit informatik e-student 2022</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Personeli akademik dhe studentët përdorin adresa zyrtare në @unitir.edu.al dhe shfrytëzojnë platformën Microsoft Teams për komunikim dhe ofrimin e informacionit me dhe për studentët, sipas udhëzimeve të publikuara në faqen e Institucionit: https://unitir.edu.al/aksesi-online/. UT-ja ka hartuar një dokument të veçantë që përcakton modalitetet e marrjes së shërbimeve dhe krijimin e hapësirave të komunikimit

	midis stafit akademik dhe studentëve gjatë procesit të mësimdhënies dhe jo vetëm. Personeli akademik shkëmben informacion me studentët përmes email-eve zyrtare dhe platformës Microsoft Teams, sipas udhëzimeve. Po ashtu, personeli dhe studentët zhvillojnë diskutime nëpërmjet rubrikave në platformë. Studentët mund të shohin rezultatet e vlerësimeve dhe komentet në rubrikën Assignment dhe Grades. Evidenca: <i>1.8 Rregullore e Universitetit të Tiranës për "Mbrotjtjen, Përpunimin, ruajtjen dhe sigurimin e të dhënave personale në Universitetin e Tiranës;</i> <i>1.10 Manual përdorimi i sistemit informatik e-student 2022)</i>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sistemi kompjuterik i FSHS/Universitetit të Tiranës, garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. Sistemi informatik në FSHS dhe platformat e përdorura (kryesisht platforma Microsoft Teams), ka siguruar raportime dhe monitorim në kohë reale të procesit të mësimdhënies, në të gjithë hallkat e tij, e nevojshme për periudhën e mësimdhënies, kontrollit dhe vlerësimit në distancë, për të krijuar raporte reale mbi ecurinë e proceseve në të gjitha nivelet.
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Universiteti i Tiranës ka një faqe interneti të dedikuar, ku publikohet informacion lidhur me programet e studimit, personelin akademik, dhe aktivitetet e ndryshme. Ky informacion është i disponueshëm në dy gjuhë: shqip dhe anglisht. Po ashtu, FSHS ka faqen e saj të internetit, ku prezantohen programet e studimit, departamentet, informacionet dhe njoftimet e ndryshme. Gjatë vizitës së grupit të akreditimit në institucion (FSHS), faqja ishte në proces përditësimi. Evidenca: https://fshs-ut.edu.al/
Konkluzione	<i>Institucioni disponon një sistem menaxhimi, i cili administron të gjithë informacionin. Regjistrat e arritjeve akademike duhet të jenë në përputhje me formatin e miratuar. Informacioni, dokumentacioni dhe aktiviteti i personelit akademik administrohen nga sistemi i brendshëm i menaxhimit. Janë të disponueshme</i>

	platforma që mundësojnë komunikimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësishme bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Çdo vit, FSHS-ja harton planin buxhetor të mbështetur në nevojat e identifikuar dhe kërkesat e stafit akademik dhe ndihmësakademik të departamenteve. DPPS paraqet një plan të tillë çdo vit. Po ashtu, FSHS-ja përgatit plane financiare për buxhetimin e periudhave afatmesme, në përputhje me ciklet më të gjata të kohëzgjatjes së një programi studimi, siç është afati 3-vjeçar. Planet i nënshtrohen konsultimeve dhe diskutimeve në dekanat, për t'u dërguar më pas në Senatin Akademik dhe, në fund, për t'u miratuar në Bordin e Administrimit të UT-së. Evidenca: 2.32 Buxheti afatmesëm FSHS 2022-2025; 2.33 Buxheti i FSHS 2023

Kriteri 2.Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Në raportin financiar të UTR dhe FSHS-së, paraqiten në mënyrë të detajuar financimi i burimeve njerëzore, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës, si dhe aksesin në bibliotekat online. Po ashtu, përfshihen detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara, kontratat e shërbimeve të lidhura me realizimin e programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë. Raporti gjithashtu përfshin të gjitha detyrimet financiare, pagat, shpenzimet dhe shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës, si dhe aksesin në bibliotekat online. Në raportin financiar janë përfshirë gjithashtu të ardhurat e përfituara nga kontratat për Kërkim dhe Zhvillim, të siguruara përmes projekteve të ndryshme ku Fakulteti i Shkencave Sociale dhe pedagogë të tij, përfshirë edhe pedagogë të DPPS, kanë qënë partnerë. Evidenca: 2.32 Buxheti afatmesëm FSHS 2022-2025; 2.33 Buxheti i FSHS 2023; 2.30 Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit, per FSHS (Tabela 18))
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Shkencave Sociale kryejnë auditime të përvitshme për të vlerësuar dhe dokumentuar gjendjen e financimit dhe efektivitetin e tij financiar. Po ashtu, Fakulteti i Shkencave Sociale harton raportet dhe pasqyrat financiare, sipas kërkesave ligjore. Administratorja e Fakultetit përgatit raportin financiar, i cili përmban të dhëna të detajuara financiare mbi të ardhurat nga tarifat e shkollimit dhe kontributet e tjera financiare për studentët, si dhe ndarjen e burimeve financiare. Evidenca: 2.34 Raport auditit FSHS
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Administratorja e FSHS-së ka realizuar raporte periodike për mënyrën e realizimit të buxhetit, duke krahasuar zërat e parashikuar me ata të realizuar. Evidenca:

	<i>Raport financiar 2022/ 2023, Pasqyra financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve 2022/ 2023</i>			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	UT/FSHS siguron qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë e duhur të këtyre programeve. Burimet e financimit të Universitetit të Tiranës, si institucion publik, janë përcaktuar në dokumentet themelore të institucionit: Universiteti i Tiranës përfiton fonde nga Buxheti i Shtetit, të cilat shpërndahen në formë granti, sipas kategorive të mëposhtme: a) granti për politikën e zhvillimit; b) granti për mësimdhënien c) granti për punën kërkimore-shkencore dhe veprimtaritë krijuese. Financimi i Universitetit, i mbështetur në modelin e financimit të buxhetit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, dhe zbatimi i skemës së financimit, realizohet sipas udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit përgjegjës për arsimin. Në analizën financiare vjetore të FSHS-së, shqyrtohet gjithashtu realizimi i treguesve të zbatimit të politikës financiare në nivel fakulteti, në përputhje me objektivat financiare dhe politikën në nivel universiteti. Evidenca: <i>Raport financiar 2022/ 2023, Pasqyra financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve 2022/ 2023</i>			
Konkluzione	UT/FSHS garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit dhe mbështetjen e kërkimit shkencor. FSHS kryen auditim periodik, duke vlerësuar dhe dokumentuar gjendjen e financimit dhe efektivitetin e përdorimit të burimeve financiare. Administratori i Fakultetit informon periodikisht departamentin mbi aktivitetin financiar të Fakultetit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	UT/ FSHS, implementon politika dhe procedura që mbulojnë të gjithë ciklin akademik, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të miratuara nga Ministria përgjegjëse për arsimin, Statutin e Universitetit të Tiranës dhe Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Sociale. Pranimi i studentëve në programin e Masterit për Administrim të Shërbimeve Sociale realizohet çdo vit akademik në përputhje me kuotat dhe kriteret e miratuara, të cilat bëhen publike dhe zyrtare në faqen e institucionit, në procedurën e pranimeve për vitin akademik dhe në udhëzimet e nxjerra nga MARS. Numri i studentëve dhe shpërndarja e tyre bëhet sipas kategorive të përcaktuara në tabelën e kuotave të pranimit (studentë për program të dytë studimi, transferime, kategori të veçanta). Kriteret e pranimit propozohen nga Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale dhe më pas miratohen nga Senati Akademik. Gjatë periudhës së zhvillimit të programit, studentët kanë në dispozicion struktura të tjera të posaçme për informacione dhe shërbime të vazhdueshme, siç janë Zyra e Informacionit, Zyra e Karrierës, Zyra e Shërbimeve, IT-ja dhe Sekretaria Mësimore. Në përfundim, diplomimi i studentëve realizohet në përputhje me rregulloren e programit. Evidenca: 3.6. Rregullore e programit të studimit Master në Administrim dhe Politikës Sociale.) 3.13. Vendim për miratimin e kuotave të pranimit për programin e studimit; 3.14. Vendim për miratimin e kriterëve të pranimit për

	<i>programin e studimit.</i> 3.6. Rregullore e programit të studimit Master në Administrim dhe Politikë Sociale)
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Politikat, kriteret dhe procedurat për të gjithë studentët, nga hyrja deri në përfundimin e studimeve, garantojnë barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët dhe studentët gjatë zhvillimit të programit të studimit. Rregullorja e Universitetit të Tiranës dhe ajo e Fakultetit të Shkencave Sociale përcaktojnë në detaje procedurat dhe praktikat e trajtimit të studentëve, që nga regjistrimi i tyre deri në përfundimin e studimeve, si dhe procedurat e transferimit të studentëve. Këto rregullore sigurojnë politika dhe procedura transparente për trajtimin e barabartë dhe të drejtë të të gjithë kandidatëve që aplikojnë dhe më pas janë pranuar në programin e Masterit Shkencor "Administrim i Shërbimeve Sociale". Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Sociale dhe ajo e programit të studimit të ciklit të parë, Bachelor në Punë Sociale, përcaktojnë në mënyrë të qartë të drejtat dhe detyrimet e studentëve, sipas rregulloreve të Universitetit të Tiranës. Të gjitha procedurat që lidhen me pranimin dhe vazhdimin e studimeve deri në diplomim janë në përputhje me ligjin për arsimin e lartë, udhëzimet e MASR-së, si dhe me statutin dhe rregulloren e brendshme të këtij programi studimi. Informacioni mbi kriteret dhe procedurën e aplikimit publikohet online, në broshurën informuese dhe është pjesë e fushatave informuese përmes fletëpalosjeve. Evidenca: 1.2. Statuti i UT (https://unitir.edu.al/ep-content/uploads/2019/08/Statuti_2018.pdf); 1.3. Rregullorja e studimeve te universitetit të Tiranës (https://unitir.edu.al/rregullore-ut/); 3.3. Rregullore e studimeve në FShS; 3.6. Rregullorja e Programit të studimit.
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta	UT/FShS harton dhe publikon politikat e përgjithshme dhe ato të veçanta që lidhen me procesin e përzgjedhjes së kandidatëve për pranimin në ciklin e dytë të studimeve Master në Administrim dhe



për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Politikë Sociale. Kriteret specifike për përzgjedhjen e kandidatëve rishikohen çdo vit dhe aplikohen për vitin akademik në vijim. Ato bëhen publike në kohë për të siguruar mundësinë e informimit për të gjithë të interesuarit. Përzgjedhja e kandidatëve për këtë program studimi bëhet përmes aplikimit nga kandidatët e interesuar, sipas kriterëve të përcaktuara në përputhje me aktet e nxjerra nga MASR për këtë qëllim. Çdo vit akademik, pranohen studentë nga Republika e Shqipërisë, si dhe shqiptarë nga trojet e Kosovës dhe nga vende të tjera, nëse ata zotërojnë gjuhën shqipe. Departamenti propozon kuotat e pranimi, kriteret e pranimi dhe përzgjedhjen e kandidatëve fitues. Këto kriterë i dërgohen rektoratit, i cili ka detyrë t'ia përcjellë MASR-së. Kriteret përfshijnë edhe ato për shtetasit e huaj. DPPS shpall listën e kandidatëve fitues për programin e studimit me renditjen përkatëse para fillimit të procesit mësimor. Evidenca: 1.2. Statuti i UT, neni 90; 1.3. Rregullorja e studimeve të Universitetit të Tiranës; 2.4. Rregullore e studimeve në FSHS (ëeb). 3.13. Vendim për miratimin e kuotave të pranimi për programin e studimit)
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kriteret dhe procedurat për pranimin dhe regjistrimin e studentëve, ecurinë e tyre gjatë programit të studimit, mundësinë e transferimit, njohjen e dijeve dhe procedurën e diplomimit janë të përcaktuara në aktet rregullatore në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme. Të gjithë dokumentet përkatëse janë të disponueshme dhe të aksesueshme për publikun. Objektivat e këtij programi janë të përcaktuara qartë dhe mbështeten në qëllimet e përgjithshme të institucioneve. Kriteret dhe procedurat për pranimin, transferimin, vlerësimin dhe diplomimin e studentëve janë të përfshira në Rregulloren e UT dhe janë të qarta, të kuptueshme dhe të aksesueshme për publikun. Plani mësimor për këtë program është bërë i njohur për të interesuarit përmes mjeteve të ndryshme informuese, si materialet,

	posterat, broshurat, etj., që shpërndahen në fillim të vitit akademik. Gjithashtu, ai mund të aksesohet online në faqen e ëeb-it të Fakultetit. E gjithë procedura është paraqitur në mënyrë transparente. Procedurat që lidhen me transferimin, njohjen e studimeve të mëparshme, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin janë të lehta për t'u kuptuar dhe të aksesueshme për publikun. Evidenca: 1.2. Statuti i UT; 1.3. Rregullorja e studimeve të universitetit të Tiranës; 2.4. Rregulloret e studimeve në FSHS; 3.6. Rregullorja e Programit të studimit.; 3.16.1. Broshura informuese/udhërrëfyese I Fakulteti;
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	UT, FSHS dhe DPPS si njësi kryesore e programit kanë realizuar komunikimin me publikun e interesuar në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit nëpërmjet disa formave: - Pasqyrimin në faqet e ëeb –it të UT dhe FSHS dhe seksionit të Departamentit të Punës dhe Politikës Sociale. - Organizimit të takimeve promovuese me studentët e programit MSH të FSHS. Përpara çdo viti të ri akademik, FSHS/ DDPPS, vë në dispozicion informacion të detajuar për kriteret e përgjithshme dhe ato specifike për t'u pranuar në programin e studimeve Master në Administrim dhe Politikë Sociale. Ato shpërndahen dhe janë të aksesueshme online ose fizikisht përmes fletëve informuese ose komunikimit të drejtpërdrejtë me grupet e interesit. Evidenca: 3.16.1. Broshura informuese/udhërrëfyese I Fakulteti Shkencave Sociale https://unitir.edu.al/kriteret-e-pranimit-kuotat-dhe-tarifat-e-studimit/ https://fshs-ut.edu.al/studentet/broshura-per-maturantet
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të	FSHS ka publikuar përpara fillimit të vitit akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizura. Evidenca: https://fshs-ut.edu.al/njoftim?id=1669

veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	https://fshs-ut.edu.al/njoftim?id=1392 Udhëzimi nr 12, 2023 "Procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë".			
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	FSHS publikon përpara fillimit të vitit akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. Ato shpërndahen dhe janë të aksesueshme online ose përmes komunikimit të drejtpërdrejtë me grupet e interesit. Në lidhje me kriteret e përzgjedhjes së studentëve të huaj janë të njëjta me studentët shqiptarë, por nga regjistrat rezultojnë të jenë kryesisht nga trojet. Evidenca: https://fshs-ut.edu.al/njoftim?id=1669 https://fshs-ut.edu.al/njoftim?id=1392 Udhëzimi nr 12, 2023 "Procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë"			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	UT/FSHS ka politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. Njoftimi i studentëve për bursa studimi ose reduktim/përrjashtim nga tarifa e studimit bëhet dhe nëpërmjet rrjeteve sociale. Evidenca: https://fshs-ut.edu.al/njoftim?id=1042 https://fshs-ut.edu.al/njoftim?id=1077 Vendim 7, 2022 "Miratimi I listave emërore shtesë për përfitim burse, reduktim/përrjashtim nga tarifa vjetore e studimit.			
Konkluzione	UT/FSHS ka dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë të gjithë ciklin akademik të studentëve, nga hyrja deri në përfundim, të cilat sigurojnë barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë. Institucioni ka hartuar, përpara fillimit të çdo viti akademik, kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Kriteret, procedurat e pranimit, përzgjedhjes, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, vlerësimit të dijeve dhe diplomimit janë të kuptueshme dhe të aksesueshme lehtësisht nga publiku. UT/FSHS ka dhe zbaton politika mbështetëse, si ndihma dhe bursat, për studentët që ndodhen në kushte të vështira financiare.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht




Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	FSHS përmes Rregullores së Universitetit të Tiranës, rregullore së programit të studimit Master në Administrim dhe Politikes Sociale, si dhe informacionit në përmbajtje të çdo programi lënde, vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë, të qartë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimin e tyre nga një vit akademik në tjetrin, deri në diplomimin e tyre. Përveçse nga pedagogu i lëndës (në mënyrë të drejtpërdrejtë apo përmes adresave zyrtare), studentët mund të informohen edhe pranë sekretarisë mësimore për vlerësimet për secilën lëndë të zhvilluar gjatë studimeve të tyre si dhe nëpërmjet sistemit e-student. Pranë sekretarisë mësimore, ata mund të informohen për kreditet e akumuluar për të kaluar nga një vit akademik në një tjetër, për procedurat për marrjen e diplomës etj. Gjithashtu, institucioni disponon mjete të komunikimit të brendshëm, si njoftime nga monitorët brenda fakultetit, si dhe afishime të posterave. Një mjet i rëndësishëm informimi në kohë reale është edhe faqja zyrtare e Fakultetit dhe llogaritë e Fakultetit dhe DPPS në rrjetet sociale. Evidenca: <i>1.6. Rregullorja e Programit të studimit;</i> <i>1.3- Rregullore e UT;</i> <i>3.16.1. Broshura informuese/udhërrëfyese I Fakultetit; ëeb site i fakultetit https://fshs-ut.edu.al/?page_id=237</i> <i>https://e-student.unitir.edu.al/e_student_ut/</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	FSHS u ofron studentëve mundësinë për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve midis programeve të të njëjtit cikël ose programeve të përafërta, brenda institucionit apo mes institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë. Ky proces realizohet duke ndjekur procedurat dhe kriteret e përcaktuara në rregulloren e UT.

	Me urdhër të dekanit, në Departamentin e Punës dhe Politikës Sociale ngrihet Komisioni i Ekuivalentimit dhe Vlerësimit, i cili miratohet prej tij dhe shqyrton kërkesat e studentëve për njohjen e kualifikimeve të mëparshme. Programi Master në Administrim dhe Politikë Sociale pranon transferime të studentëve nga institucione të tjera, vendase ose të huaja, publike apo jopublike, dhe gjithashtu lejon transferimin e studentëve të tij drejt këtyre institucioneve. Evidenca: 1.2. Statuti i Universitetit të Tiranës, 2018; 1.3. Rregullore e Universitetit të Tiranës, 2022; 2.4. Rregullore e FSHS 2023 3.6. Rregullore e programit të studimit)
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	FSHS informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. Në rregulloren e programit të studimit Master në Administrim dhe Politike Sociale (Kreu V) specifikohen kriteret dhe procedurat për vlerësimin e studentëve, që nga vlerësimi për lëndët deri tek diplomimi. Në mënyrë më të specifikuar, format dhe procedurat e vlerësimit të dijeve janë të parashikuara edhe në syllabuset e lëndëve përbërëse të programit. Ato paraqiten nga pedagogu/ja e lëndës në fillim të çdo semestri dhe bëhen të njohura për studentët që në takimin e parë me ta. Studenti ka të drejtë të njihet me tezën e provimit pas korrigjimit, pasi të bëhet edhe ç'sekretimi I tyre. Ai ka të drejtë të njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë si dhe me pikët në çdo rubrikë, si dhe ka të drejtën e ankimit brenda 48 orëve nga marrja dijeni e rezultateve. Evidenca: 1.2. Rregullore e UT-së; 3.6. Rregullore e programit të studimeve FSHS; 4.3. Syllabuset e lëndëve të programit të studimit)
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe	FSHS dhe DPPS informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. Në Rregulloren e UT-së, parashikohen qartë kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programet e studimit Master Shkencor. Në rregulloren e diplomimit, student



diplomimit në programin e studimit.	njihet me udhëzime të specifikuara lidhur me strukturën e punimit të diplomës, i cili është gjithashtu pjesë e prezantimit që bëhet në fillim të vitit akademik. Fazat kohore të dorëzimit dhe mbrojtjes së diplomës bëhen të ditura në fillim të çdo viti akademik. Evidenca: 3.6. Rregullore e programit të studimit; 3.8. Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit 2.11. Rregullore e Diplomimit
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	FSHS dhe DPPS publikojnë udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale si njësi bazë përgjegjëse e programit të studimit punon në fillim të çdo viti punon intensivisht për tërheqjen e kandidatëve potencialë për studentë duke ndërmarrë një sërë veprimtarish informuese në formën e takimeve të hapura me studentët e diplomuar në ciklin e parë të FSHS dhe më gjerë, ku paraqiten informacione në lidhje me programin e studimit, mundësitë e punësimit si edhe aftësimin e vazhdueshëm të studentëve duke qenë të hapur ndaj feedback, diskutimeve apo sugjerimeve të mundshme. Evidenca: 3.10. Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit; 3.16. Politika e marketingut për programin e studimit)
Konkluzione	FSHS, përmes rregulloreve të universitetit, fakultetit, programit të studimit, sekretarisë mësimore, faqes në internet dhe platformave si Microsoft Teams, vë në dispozicion informacion të plotë dhe të detajuar mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve, si dhe kalimin nga një vit akademik në tjetrin. Në përputhje me rregulloren e programit të studimit Master në Administrim dhe Politikë Sociale (Kreu V), përcaktohen kriteret dhe procedurat për vlerësimin e studentëve, nga vlerësimi i lëndëve deri te diplomimi. Rregullorja e diplomimit parashikon të gjitha kriteret dhe procedurat për hartimin e punimit të diplomës dhe procesin e diplomimit në programin e studimit. Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale (DPPS) organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	DPPS, përmes një sërë aktiviteteve, informon studentët e programit të studimit Master në Administrim Social mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit në mënyrat e mëposhtme: Takime informuese dhe materiale informuese – Organizohen takime dhe shpërndahen fletë informuese për studentët e ardhshëm, duke ofruar një panoramë të plotë mbi kohëzgjatjen e studimeve, strukturën dhe organizimin e programit Master në Administrim dhe Politikë Sociale, si dhe përmbajtjen e tij kryesore. Sekretaria mësimore – Siguron informacion të detajuar për studentët mbi kohëzgjatjen, strukturën dhe organizimin e programit. Takimi i mirëseardhjes për studentët e vitit të parë – Në ditën e parë të fillimit të vitit akademik, përgjegjësi i departamentit, koordinatori i programit dhe pedagogët e angazhuar mbajnë një takim informues me studentët e vitit të parë. Ky takim ka për qëllim orientimin e studentëve, njohjen me programin dhe sqarimin e aspekteve kryesore të strukturës dhe organizimit të tij. Komunikimi i vazhdueshëm – Koordinator i programit, sekretaria mësimore dhe stafi akademik sigurojnë informimin dhe orientimin e studentëve gjatë gjithë ndjekjes së programit të studimeve.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të	Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale, vendosin në dispozicion të studentëve gjithë informacionin e nevojshëm mbi programet e studimit, procesin mësimor, rregulloren e universitetit dhe të fakultetit, rregulloren e studimeve, procedurat në lidhje me

posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	aktivitete të ndryshme të procesit mësimor, syllabusët, organizimin e lëndëve, etj. Të gjitha këto informacione janë të aksesueshme nga studentët DPPS i mundëson studentëve të këtij program informacion të nevojshëm ku studentët njihen më gjerësisht me programin që do të ndjekin, strukturën dhe përmbajtjen e tij, lëndët që do të zhvillojnë, mundësitë që ofron ky program studimi, rregullat për frekuentimin dhe vlerësimin, praktikën mësimore, diplomimin, etj. Evidenca: 3.6. Rregulloret e programit të studimit; Syllabusët si Aneks RVB; 4.2. Plani mësimor)
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	FSHS dhe DPPS informojnë në mënyrë të vazhdueshme studentët mbi mundësitë e punësimit dhe mbështetjen institucionale për orientimin e tyre në tregun e punës. Gjatë studimeve, veçanërisht në semestrin e fundit, studentët marrin informacion më intensiv mbi programet e studimeve master që DPPS ofron, si dhe mbi mundësitë për punësim menjëherë pas diplomimit. Për të siguruar një orientim sa më efektiv drejt tregut të punës, DPPS ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione, agjenci dhe organizata për realizimin e praktikave profesionale dhe intershipeve, të cilat shpesh kanë shërbyer si një pikë hyrëse në tregun e punës për studentët. Institucioni ofron një gamë të gjerë mundësish për zhvillimin profesional të studentëve, përfshirë mundësi punësimi, mbështetje me grante, intershipe të ndryshme, trajnime dhe bursa për mobilitet në institucione të arsimit të lartë brenda dhe jashtë BE-së. Përtej mbështetjes së ofruar nga departamenti, Zyra e Alumnit dhe Karrierës në FSHS, në bashkëpunim me departamentet, organizon aktivitete që ndihmojnë studentët të afrohen me tregun e punës dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre, duke i bërë më të përgatitur dhe konkurrues në fushën profesionale. Evidenca: 3.21. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe e partnerëve për praktikën profesionale). 1.26. Analiza e tregut të punës; Evidenca: 3.21.1 Të dhëna përmbledhëse për punësimin e studentëve 3.21.1. Tabelë përmbledhëse për trajnimet profesionale për studentët e diplomuar)
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i	Studentët e FSHS-së kanë në dispozicion kapacitete dhe logjistikë të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mësimor, nëpërmjet

gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	strukturave dhe kanaleve të ndryshme të komunikimit, qoftë përmes komunikimit verbal apo njoftimeve zyrtare në faqen e internetit të FSHS-së. Pasi fitojnë statusin e studentit, atyre u vihet në dispozicion një username dhe një passëord personal për përdorimin e sistemit informatik (platforma Microsoft Teams gjatë mësimit online). Përmes kësaj platforme, studentët marrin informacione mbi procesin mësimor, si oraret e leksioneve, klasat ku zhvillohen, si dhe njoftime mbi zëvendësimet e leksioneve dhe ndryshime të tjera akademike. Përmes sekretarisë mësimore të FSHS-së afishohen të gjitha informacionet e sipërcituara. Studentët kanë mundësi të aksesojnë informacion të plotë mbi organizimin e mësimit edhe përmes orarit të afishuar në mjediset e FSHS-së. Studentët e programit Master në Administrim dhe Politikë Sociale informohen në mënyrë të plotë dhe të vazhdueshme mbi organizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor, si dhe mbi logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të mësimi. Evidenca: <i>1.2. Rregullorja e Universitetit të Tiranës, 2022</i> <i>2.4. Rregullorja e FSHS-së, 2023</i> <i>3.6. Rregullorja e programit të studimit</i> <i>2.9. Rregullorja e Sekretarisë Mësimore</i>
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Informacioni mbi programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit, platformës "E-student", e cila përdoret për çështjet akademike të studentëve. Kjo platformë mbulon regjistrimin, menaxhimin e studentëve, stafin akademik, degët e studimit, lëndët, syllabuset, materialet e studimit, oraret mësimore, provimet, pagesat studentore dhe njoftime të ndryshme. Për procesin e mësimdhënies, përdoret edhe platforma "Microsoft Teams", e cila ofron mundësi të shumta për organizimin e mësimi. Përmes saj, pedagogët mund të caktojnë detyra kursi, të zhvillojnë dhe administrojnë të gjitha format e vlerësimit, të krijojnë pyetësorë, evente, forume diskutimi online mes studentëve dhe pedagogëve, si dhe të shfrytëzojnë shumë funksione të tjera interaktive. Sistemi u mundëson pedagogëve

	monitorim të plotë mbi aktivitetin e studentëve dhe përdorimin e platformës. Çdo informacion është i aksesueshëm në kohë reale për të gjithë të interesuarit. Evidence: https://e-student.unitir.edu.al/e_student_ut/			
Konkluzione	<i>FSHS dhe DPPS informojnë studentët në mënyrë të detajuar mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit, duke vënë në dispozicion udhëzues dhe dokumentacion të posaçëm mbi lëndët/modulet, përmbajtjen e tyre dhe veprimtaritë formuese. FSHS dhe DPPS ofrojnë informacion mbi mundësitë e punësimit dhe mbështetjen institucionale për orientimin e studentëve drejt tregut të punës. FSHS dhe DPPS menaxhojnë informacionin akademik dhe administrativ përmes sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit.	FSHS/DPPS, përmes sekretarisë mësimore dhe Zyrës së Alumnit dhe Karrierës, mbledh dhe ruan statistika vjetore mbi numrin e studentëve dhe të diplomuarve në programin e studimit. Ky proces realizohet në mënyrë të vazhdueshme për programin Master në Administrim dhe Politikë Sociale. Këto statistika shërbejnë edhe për raportimet që bëhen në MAS. Evidenca: 4.8. Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe dalje për programin e studimit.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e	FSHS/DPPS disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, nga momenti i pranimi deri në diplomim. Këto statistika përfshijnë edhe tërheqjet nga

tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	programi, largimet para përfundimit të studimeve dhe rastet e mospërfundimit me sukses të vitit akademik. Për 3 vitet e fundit akademike, rezultojnë të regjistruar: - 2024-2025, 40 Studentë; - 2023-2024, 31 Studentë; - 2022-2023, 39 Studentë. Arkiva kryesore përbëhet nga dosjet e plota të studentëve, të cilat përmbajnë të dhënat e tyre që nga regjistrimi deri te diplomimi. Ky dokumentacion ruhet në formë të printuar, elektronike dhe në regjistrat e sekretarisë mësimore. Sekretaria mësimore e Fakultetit të Shkencave Sociale administron dhe përpunon të dhënat mbi numrin e studentëve të regjistruar, largimet dhe ecurinë akademike të tyre. Këto të dhëna janë të disponueshme si në bazën e të dhënave elektronike të sekretarisë, ashtu edhe në formë hard-copy dhe përpunohen në nivel programi studimi. Evidenca: <i>4.8. Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe dalje për programin e studimit.</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Të dhënat statistikore të studentëve në Universitetin e Tiranës menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit, si në formë elektronike ashtu edhe të shkruar. Sektori i IT-së siguron aksesin elektronik për studentët dhe stafin e autorizuar, duke mundësuar gjithashtu printimin dhe verifikimin e lehtë të këtyre të dhënave. Rregulloret e posaçme përcaktojnë kompetencat dhe detyrat e stafit dhe studentëve, duke garantuar akses të lehtë në shërbime dhe mbrojtjen e të dhënave. Menaxhimi i të dhënave nga sekretaria mësimore respekton standardet e privatësisë dhe ato janë të aksesueshme vetëm për personat e autorizuar. Përveç kësaj, të dhënat e studentëve administrohen edhe përmes sistemit "E-Student", ku çdo student dhe staf i autorizuar disponon

	një email institucional dhe një fjalëkalim unik për aksesin në platformë. Evidenca: 1.3. Rregullore e Universitetit të Tiranës, 2022; 2.9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore; 1.8. Rregullore e UT "Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurimin e të dhënave personale"
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Sekretaria mësimore e Fakultetit të Shkencave Sociale ka përgjegjësinë për përpilimin, administrimin dhe ruajtjen e regjistrat themeltar, i cili mbushet si në formë manuale, ashtu edhe elektronike. Ajo menaxhon regjistrat e çdo programi studimi, regjistrin e diplomave, dosjet personale të studentëve, dokumentet për procedurat e transferimit dhe çregjistrimit, regjistrin bazë të notave, procesverbalet e provimeve dhe shumë të tjera. Marrja e informacionit dhe qasja në dokumentacionin për personelin dhe studentët kryhet në përputhje me ligjin nr. 887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Puna e tyre është pjesë e analizave të UT-së në raportimet e tyre vjetore. Evidenca: 2.9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore; 1.8. Rregullore e UT "Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurimin e të dhënave personale"
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	DSSP në raportin e saj vjetor ofron informacion të plotë lidhur me profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre. Po ashtu, këto të dhëna përfshihen në raportimet institucionale dhe pasqyrohen në raportin vjetor të UT-së, i cili miratohet nga Senati Akademik (zakonisht në muajin dhjetor). Zyra e Karrierës/Alumnit është struktura përgjegjëse për ruajtjen e kontakteve me të diplomuarit dhe kontaktimin e tyre në mënyrë të herëpashershme, për të gjurmuar të diplomuarit dhe përditësuar bazën e të dhënave, si dhe për të mbajtur lidhjet me universitetin. DPPS dhe Zyra e Alumnit vazhdojnë komunikimin me të diplomuarit për të ndjekur ecurinë e tyre në tregun e punës dhe karrierën pas diplomimit. Evidenca: 2.16. Analizë vjetore e punës së Fakultetit të Shkencave Sociale

	2021-2022, 2022-2023; 3.18 Raport për veprimtarinë e programit të studimit 2021-22, 2022-23 dhe 2023-24.			
Konkluzione	FSHS/DPPS disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve dhe të diplomuarve në programin e studimit, numrin e studentëve të regjistruar në program, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit ose mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit. DPPS ka hartuar raporte analitike dhe periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe mbi shkallën e cilësisë së punësimit të studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Universiteti i Tiranës ka parashikuar në aktet e tij rregulluese përfshirjen dhe angazhimin aktiv të studentëve në proceset dhe strukturat vendimmarrëse. Statuti i Universitetit garanton pjesëmarrjen e tyre në organe të rëndësishme, si: • Senati Akademik i UT • Komisioni i Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët • Njësitë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në njësitë kryesore Evidenca: 1.2. Statuti i Universitetit të Tiranës, 2018.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo	Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, siguron që përfshirja e studentëve në vendimmarrje, këshillim dhe vlerësimin e procesit akademik është reale, konkrete, efektive dhe e matshme me rezultate të qarta dhe të verifikueshme.

vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Studentët marrin pjesë në vlerësimin e procesit akademik në mënyra të ndryshme. Përfshirja e tyre garantohej si nga kuadri rregullator (siç përmendet më sipër), ashtu edhe nga mekanizmat e krijuar për një pjesëmarrje sa më të gjerë, si për shembull realizimi i pyetësorëve. Ata janë anëtarë të Senatit Akademik dhe marrin pjesë në mbledhjet e tij. Çdo komision përfshin një përfaqësues studentor. Për më tepër, studentët marrin pjesë në vlerësimin e stafit akademik përmes pyetësorëve të posaçëm për këtë qëllim. Evidenca: <i>4.18a dhe 4.18b Raport i anketimit të studentëve për cilësinë e mësimdhënies 2022 dhe 2023).</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributit të tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	DPPS garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit. Studentët janë përfshirë dhe në rishikimin e kurrikulës së programit të studimit Master në Administrim dhe Politikë Sociale në vitin 2023, ku është shpërndarë një pyetësor në google forms për të marrë mendimin e studentëve në vitin e 3-të të studimeve. Sugjerimet e tyre janë eksploruar më shumë në diskutime të mëtejshme dhe janë pasqyruar në ndryshimin e fundit të planit mësimor. Evidenca: <i>4.17. Feedbacku i studentëve për përmirësimin e kurrikulës; 4.2.3. Ndryshimet në planet mësimore, ndryshimi i vitit 2023 – 24)</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Studentëve u ofrohet një proces transparent për mënyrën e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve, i cili përcaktohet në rregulloret e brendshme të programit të studimit. Për të siguruar ndershmërinë e procesit, zbatohen masa të tilla si sekretimi i provimeve, argumentimi i vlerësimit nga pedagogu, organizimi i seancave sqaruese dhe mundësia për të kërkuar rivlerësim nga një komision i posaçëm. Studentët kanë të drejtën të paraqesin kërkesat e tyre zyrtarisht pranë strukturave të njësisë bazë, duke respektuar rregullat dhe afatet kohore të përcaktuara nga FSHS për këtë qëllim. Evidenca: <i>1.3. Rregullore e Universitetit të Tiranës, 2022;</i>

Konkluzione	<i>UT/FSHS kanë parashikuar në Statutin dhe Rregulloren e tyre përfshirjen dhe angazhimin e studentëve në organet vendimmarrëse dhe këshilluese, në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Pjesëmarrja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim dhe vlerësimin e procesit akademik është reale, konkrete, efektive dhe produktive. Studentët marrin pjesë në mënyrë aktive në hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit mbi baza të rregullta, duke reflektuar sugjerimet dhe kontributin e tyre në këtë proces. Sipas rregullores së UT dhe FSHS, studentëve u garantohej e drejta për të shprehur mendimin e tyre mbi barazinë dhe ndershmërinë e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultateve, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit, njësisë ose pedagogut përgjegjës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	FSHS/DPPS ka në funksion struktura dhe procedura të posaçme për informimin dhe shërbimin ndaj studentëve, në përputhje me kuadrin ligjor dhe aktet rregullatore të institucionit. Në nivel fakulteti, departamenti dhe programi, operojnë njësitë e mëposhtme për të siguruar informim të vazhdueshëm dhe mbështetje për studentët: - Sekretaria mësimore, - sekretaria e departamentit, - koordinatori i programit dhe - zyra e informacionit ofrojnë asistencë dhe informacion gjatë gjithë periudhës së studimeve të studentëve. Faqja zyrtare e Fakultetit në ëeb (e cila në momentin e vizitës ishte në përditësim) pasqyron të gjitha aktivitetet e zhvilluara në FSHS, përfshirë edhe ato të DPPS, dhe përditëson informacione të detajuara për studentët, stafin dhe palët e treta, në kuadër të

	transparencës institucionale. Fakulteti është gjithashtu aktiv në rrjetet sociale dhe përdor komunikimin e brendshëm përmes e-maileve zyrtare dhe/ose platformës Teams. Për më tepër, studentët mund të aksesojnë një sërë shërbimesh informuese në kohë reale përmes faqes zyrtare: https://fshs-ut.edu.al/. Evidenca: 2.5. <i>Struktura organizative e FSHS 2024;</i> 2.9. <i>Rregullore e Sekretarisë Mësimore;</i> 2.22. <i>Rregullore e Zyrës së Këshillimit të Karrierës;</i> 2.23. <i>Politika për mbështetjen e studentëve).</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	FSHS/DPPS ka krijuar dhe vënë në funksion një sistem të dedikuar për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistencën në çështje që lidhen me procesin mësimor dhe programin e studimit. Studentët e programit Master në Administrim dhe Politikë Sociale mund të drejtohen te sekretaria mësimore, sekretaria e departamentit dhe koordinatori i programit për çdo informacion apo çështje që lidhet me procesin akademik dhe vijueshmërinë e studimeve të tyre. Për çështje që shkojnë përtej mbarëvajtjes së studimeve, si jeta studentore, mundësitë e punësimit dhe zhvillimit të karrierës, apo ruajtja e kontakteve me institucionin pas diplomimit, studentët mund të marrin informacion edhe pranë Zyrës së Informimit dhe Zyrës së Alumnit dhe Karrierës. Informacionet e nevojshme publikohen në forma të ndryshme, si fletë informuese, guida, rregullore dhe fletëpalosje, të cilat janë të disponueshme në sekretari dhe në zyrat përkatëse (p.sh., pranë zyrës së financës gjendet një tryezë me materiale informative për studentët). Gjithashtu, në mjediset e FSHS janë instaluar ekrane elektronike, ku shfaqen në mënyrë të vazhdueshme informacione të rëndësishme mbi aktivitetet akademike dhe njoftime të tjera të fakultetit. Evidenca: 2.9. <i>Rregullore e Sekretarisë Mësimore;</i> 2.22. <i>Rregullore e Zyrës së Këshillimit të Karrierës;</i> 2.23. <i>Politika për mbështetjen e studentëve).</i>

Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Në FSHS funksionon një sistem i dedikuar për informimin, këshillimin, ndjekjen dhe mbështetjen e studentëve në çështje që lidhen me procesin mësimor dhe përtej tij. Ky sistem operon përmes strukturave të ngritura, si shërbimi ndaj studentit dhe koordinatori i programit. Për këshillimin dhe zhvillimin e karrierës, Fakulteti ka krijuar Zyrën e Alumnit dhe Karrierës, e cila, në bashkëpunim me departamentet, mbështet studentët në planifikimin e karrierës së tyre duke ofruar shërbime të vazhdueshme, si: • Këshillim për karrierën • Informacion mbi mundësitë e punësimit • Informacion mbi programet e praktikës profesionale • Informacion mbi trajnime dhe ëorkshop-e Në programin Master në Administrim dhe Politikë Sociale, studentët marrin orientim për karrierën e tyre të ardhshme edhe përmes praktikave profesionale në institucione. Koordinator i departamentit dhe pedagogët e angazhuar në supervizimin e praktikave ofrojnë mbështetje të vazhdueshme për studentët, duke lehtësuar procesin e vendosjes në vendin e praktikës, i cili shpesh shërben si një urë lidhëse drejt tregut të punës. Evidenca: 3.11. <i>Vendim përcaktimin e koordinorit të programit të studimit;</i> 3.12. <i>Përshkrimi I detyrave të koordinorit të programit të studimit;</i> 4;2.22. <i>Rregullore e Zyrës së Këshillimit për Karrierë;</i> 2.5. <i>Struktura organizative e FSHS;</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e	Për komunikimin në vazhdim mes Zyrës së Karrierës dhe të diplomuarve përdoren kontaktet e mbajtura (adresa e emailit, telefoni, rrjetet sociale etj.) që nga përfundimi i studimeve dhe përditësohen ato sa herë jepet punësia përmes Zyra e Karrierës ndjek të diplomuarit pas përfundimit të studimeve, duke mbledhur, përpunuar dhe ruajtur të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të tyre. Këto informacione u vihen në dispozicion studentëve, si dhe organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse.

autoriteteve drejtuese përkatëse.	Për të ruajtur komunikimin me të diplomuarit, Zyra e Karrierës përdor kontaktet e mbajtura gjatë studimeve (email, telefon, rrjete sociale etj.), të cilat përditësohen rregullisht përmes komunikimit të drejtpërdrejtë. Me kërkesë, Zyra e Karrierës harton dhe shpërndan raporte mbi ndjekjen dhe zhvillimin e karrierës së të diplomuarve, duke i vënë ato në dispozicion të organeve dhe departamenteve përkatëse. Si Fakulteti i Shkencave Sociale ashtu edhe DPPS organizojnë në mënyrë të vazhdueshme evente dhe aktivitete, siç janë takimet për përvjetorët e diplomimit, me qëllim mbledhjen, angazhimin dhe promovimin e alumnit të programeve të studimit. Evidenca: 1.26. Analiza e tregut të punës; 3.21.1. Të dhëna përmbledhëse për punësimin e studentëve).			
Konkluzione	<i>UT/FSHS ka ngritur një sistem të posaçëm dhe strukturë të dedikuara për informimin, këshillimin dhe mbështetjen e studentëve. Ky sistem siguron ndjekjen e përparimit të tyre akademik dhe asistencën për çështje që lidhen me procesin mësimor dhe programin e studimit. UT/FSHS u ofron studentëve një sistem efektiv të këshillimit të karrierës, duke i ndihmuar ata në planifikimin profesional dhe orientimin drejt tregut të punës. Zyra e Karrierës dhe DPPS ndjekin të diplomuarit, mbledhin, përpunojnë dhe ruajnë të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të tyre. Këto të dhëna u vihen në dispozicion studentëve, si dhe organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Universiteti i Tiranës ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, bazuar në fushat e studimit. Në Statutin e Universitetit përshkruhen qartë procedurat specifike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve akademike. Njëkohësisht në manualin e cilësisë së UT, i cili trajton në mënyrë të detajuar standartet e sigurimit të cilësisë së mësimdhënies në UT, përmirësimin e programeve të studimit, mënyrën e përzgjedhjes së teksteve dhe materialeve shtesë mësimore si dhe metodat përmirësimi në vazhdueshëm të metodave të mësimdhënies. UT i kushton një rëndësi të veçantë hartimit të udhëzuesve institucionalë që synojnë zhvillimin dhe zbatimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies, në përputhje me fushën e studimit, lëndët dhe modulet përkatëse. Institucioni ndjek politika dhe procedura të qarta për zbatimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë, duke synuar përmirësimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin akademik. Hartimi i këtyre udhëzuesve përputhet me vizionin dhe misionin e institucionit. Evidenca: 1.2. Statuti i UT-së, neni 139; 1.6. Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT. 1.11 Manuali i cilësisë
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Fakulteti i Shkencave Sociale dhe DPPS kanë një strategji të qartë dhe disponojnë instrumente efektive për vlerësimin e vazhdueshëm të cilësisë në të gjitha aspektet e veprimtarive akademike, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. Manuali i Cilësisë i UT përcakton qartë objektivat e sigurimit të cilësisë, duke përfshirë veprimtarinë mësimore, kërkimore dhe zhvillimore inovative. Evidenca: 1.11 Manuali i Cilësisë

Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Shkencave Sociale sigurojnë përfshirjen aktive të studentëve në hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit në mënyrë të rregullt, duke reflektuar kontributin e tyre në këto procese. Këshillat e studentëve shprehin mendime dhe propozojnë zgjidhje për çështje me interes të përgjithshëm në UT, përfshirë planet dhe programet e studimit. Statuti i UT dhe rregulloret përkatëse u garantojnë studentëve të drejtën për të shprehur mendimin e tyre mbi barazinë dhe ndershmërinë e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Gjithashtu, studentët marrin pjesë në vlerësimin periodik të metodave të mësimdhënies dhe vlerësimit të dijeve, duke përfshirë edhe mundësinë për të paraqitur ankimime. Evidenca: 1.2 Statuti i UT-së, neni 139 1.6 Rregullorja për sigurimin e cilësisë në UT 3.3 Rregullorja e Departamentit të Punës dhe Politikës Sociale 3.6 Rregullorja e programit të studimit Master Shkencor “Administrim i Shërbimeve Sociale” 3.23.1; 3.23.2 Raport i anketimit të kënaqësisë së studentëve për cilësinë e mësimdhënies (viti 2022-2023)
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSCB) publikon rezultatet e vlerësimit, të cilat diskutohen edhe në takime informuese dhe dëgjesa me studentët. Këto rezultate dokumentohen dhe i bëhen të njohura autoriteteve vendimmarrëse. Nga mbledhjet e dekanatit dalin udhëzime mbi zhvillimin e mësimin, problematikat e hasura dhe çështjet specifike, të cilat më pas ndiqen nga përgjegjësi përkatës i departamentit. Departamenti raporton mbi ecurinë e procesit në strukturat dhe autoritetet akademike e administrative. Parimet mbi të cilat bazohet Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë janë të përcaktuara në rregullore që garantojnë transparencë dhe sigurojnë informimin e të gjithë partnerëve dhe publikut të gjerë mbi performancën e UT-së, njësisë të tij, programeve, kurrikulës dhe shërbimeve.

	Të gjitha raportet e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit janë bërë publike në faqen zyrtare të internetit të UT dhe FSHS. Evidenca: <i>1.11. Manuali dhe Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë e UT-s ëdhe Paketa e Instrumentave të Cilësisë).</i> <i>1.2. Statutii UT-së;</i> <i>1.3. Rregullore e Përgjithshme e UT-së, shoqëruar me nenet përkatëse;</i> <i>3.5. Strategji e zhvillimit të programit;</i> <i>3.3. Rregullore e njësisë kryesore;</i> <i>3.6. Rregullorja e programit të studimeve;</i>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	FSHS dhe DPPS promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Rezultatet e vlerësimit shoqërohen me një plan masash të marra nga njësia bazë përkatëse në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brëndshëm të Cilësisë. Raportet e Njësisë së Sigurimit të Brëndshëm të Cilësisë po ashtu japin rekomandime, të cilat i paraqiten dekanatit për të ndërmarrë hapa konkretë dhe plane veprimi për trajtimin e problemeve të evidentuara. Raportet e vlerësimit të brendshëm, diskutohen në të gjitha njësitë e UT, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në kryerjen e këtyre veprimtarive në të ardhmen. Mbi këtë bazë, hartohen planet vjetore të punës së njësive bazë, hartohen urdhra e vendime në nivel institucional që orientojnë njësitë bazë e kryesore lidhur me zhvillimin e kultures së cilësisë në institucion. Evidenca: <i>1.2. Statutii UT-së;</i> <i>1.3. Rregullore e Përgjithshme e UT-së, shoqëruar me nenet përkatëse;</i> <i>3.5. Strategji e zhvillimit të programit;</i> <i>3.3. Rregullore e njësisë kryesore;</i> <i>3.6. Rregullorja e programit të studimeve;</i> <i>1.11. Manuali dhe Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë e UT-s ëdhe Paketa e Instrumentave të Cilësisë;</i> <i>3.18. Raportet vjetore të DPPS).</i>
Konkluzione	<i>UT/FSHS ka hartuar udhëzues institucionalë për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies,</i>

	<i>në përputhje me fushën e studimeve, lëndët dhe modulet përkatëse. UT/FSHS/DPPS kryejnë vlerësime periodike mbi aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. Studentët marrin pjesë në vlerësimin periodik të metodave dhe formave të mësimdhënies, si dhe të procesit të vlerësimit të dijeve, duke përfshirë mundësinë e paraqitjes së ankimeve. Rezultatet e anketimit bëhen publike dhe shërbejnë për të promovuar vlerësimin e vazhdueshëm të metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të dijeve, duke përfshirë edhe trajtimin e ankimeve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Shkencave Sociale kanë hartuar politika dhe dokumente të cilat zbatohen nëpërmjet procedurave dhe instrumenteve transparente, me qëllim drejtimin dhe orientimin e punës së strukturave të posaçme, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen e studentëve, në funksion të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë realizohet përmes Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë, si në nivel institucional ashtu edhe në nivel të njësive kryesore. Politikat e miratuara nga institucioni, të cilat synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, zbatohen përmes një sërë instrumentesh të përcaktuara në rregulloret institucionale. Njëkohësisht, në FSHS funksionon Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë, si dhe janë ngritur Njësitë e Vlerësimit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJVSBC) në njësitë kryesore të UT-së. Përbërja e këtyre njësive përcaktohet nga vetë njësitë kryesore dhe duhet të përfshijë edhe përfaqësues të studentëve,

	duke siguruar transparencë dhe pjesëmarrje aktive në proceset e vlerësimit. Rregulloret institucionale përfshijnë politikat e miratuara për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, të cilat realizohen përmes instrumenteve të përcaktuara me qëllim rritjen e standardeve akademike dhe sigurimin e një mësimdhënieje cilësore dhe të përmirësuar vazhdimisht. Evidenca: <i>1.4. Strategjia e UT;</i> <i>1.6. Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë dhe Paketën e Instrumentave të Cilësisë;</i> <i>1.2. Statuti i UT-së;</i> <i>1.3. Rregullore e Përgjithshme e UT-së, shoqëruar me nenet përkatëse; 3.5. Strategji e zhvillimit të programit;</i> <i>3.3. Rregullore e njësisë kryesore;</i> <i>3.6. Rregullorja e programit të studimeve;</i> <i>2.4. Rregullore e studimeve në FShS (ëeb);</i> <i>1.11. Manuali dhe Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë e UT-së dhe Paketa e Instrumentave të Cilësisë).</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Shkencave Sociale kanë ngritur dhe mbajnë në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë (SBSC), duke zbatuar një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Kjo strategji përfshin jo vetëm studentët, por edhe bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm. Spektori i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), i cili është pjesë e Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë, përbëhet nga personel ndihmës akademik, duke përfshirë një drejtor, një përgjegjës dhe dy specialistë. Ky sektor ka hartuar Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë, e cila shërben si bazë për funksionimin dhe zhvillimin e standardeve cilësore brenda institucionit. Gjithashtu, janë krijuar Komisionet e Përhershme të Sigurimit të Cilësisë, si në nivel institucional ashtu edhe në nivelin e njësisë kryesore. Në Fakultetin e Shkencave Sociale (FSHS), funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila ka hartuar dokumente dhe analiza që lidhen me procesin e sigurimit të cilësisë së brendshme.

	Studentët janë në qendër të Strategjisë së Zhvillimit të Institucionit, dhe opinioni i tyre mbi programet e studimit dhe lëndët përbën një burim të rëndësishëm informacioni për përmirësimin e shërbimeve akademike, ndihmës akademike dhe vetë programeve mësimore të ofruara nga universiteti. Për të garantuar pjesëmarrjen aktive të stafit dhe studentëve, Universiteti i Tiranës ka ngritur strukturat e nevojshme në të gjitha nivelet, si në nivel institucioni ashtu edhe në nivel fakulteti, duke siguruar një qasje gjithëpërfshirëse ndaj sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë. Evidenca: <i>1.11. Manuali dhe Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë e UT-së dhe Paketa e Instrumentave të Cilësisë)</i> <i>1.2. Statuti i UT-së;</i> <i>1.3 Rregullore e Përgjithshme e UT-së,</i> <i>3.5. Strategji e zhvillimit të programit</i> <i>3.3. Rregullore e njësisë kryesore;</i> <i>3.6. Rregullorja e programit të studimeve;</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Dy prej instrumentave kryesorë për sigurimin e cilësisë në UT, janë Akreditimi Institucional si dhe Akreditimi i Programeve të studimit, të cilat janë dhe detyrim ligjor për çdo IAL (neni 104 dhe 106, LAL 80/2015). UT në vitin 2018, ishte objekt i vlerësimit të jashtëm institucional me qëllim vlerësimin e shkallës së përmbushjes së Standarteve Shqiptare Shtetërore të Cilësisë, hyrë në fuqi në vitin 2011 akreditim i cili u mbyll me rezultat pozitiv për UT. Njësia kryesore, Fakulteti i Shkencave Sociale ka një paketë me instrumente për sigurimin e cilësisë që përbëhet nga formularë, pyetësorë dhe raporte për njësinë kryesore, njësitë bazë, për pedagogët, studentët, punëdhënësit të cilat janë të parashikuara në rregullore e manuale Në kuadër të sigurimit të jashtëm të cilësisë, UT i është nënshtruar akreditimit të jashtëm nga ASCAL dhe ka marrë akreditim ininstitucional deri ne Tetor 2022, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Njësia bazë, Departamenti i Pune dhe Politike Sociale harton raporte periodike vjetore për ecurinë e departamentit, problematikat e hasura, dhe zgjidhjet e sugjeruara. Këto raporte qarkullohen në

	departament nëpërmjet e-mail'it dhe përgjegjësjë e departamentit mban nga një kopje që e paraqet në mbledhjen e Dekanatit. Evidenca: 1.2. Statuti i UT-së; 1.3. Rregullore e Përgjithshme e UT-së, shoqëruar me nenet përkatëse; 3.5. Strategji e zhvillimit të programit; 3.3. Rregullore e njësisë kryesore
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Në DPPS/FSHS, nga Njësia e Vlerësimit dhe Sigurimit të Cilësisë, është bërë anketimi i studentëve për procesin e vlerësimit të pedagogëve të jashtëm, për semestrin e dytë të vitit akademik 2019-2020 me qëllim vlerësimin e cilësisë së programeve mësimore, si dhe matjen dhe vlerësimin e mësimdhënies, duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe praktikën më të mira. Për vlerësimin e performancës së personelit akademik, Senati i Ut-së ka miratuar Manualin e Vlerësimit të Performancës së stafit akademik të UT-së, që do të shërbejë si instrument potencial për sigurimin e cilësisë brenda UT-së. Bazuar në këtë dokument, FSHS/DPPS çdo vit realizon vlerësimin e performancës së personelit akademik dhe ndihmës akademik e administrativ në lidhje me zbatimin e programeve të miratuara nga departamentet dhe fakultetet sipas formatit të miratuar me Çdo vit akademik DPPS bën një analizë të detajuar të punës së departamentit ku përfshihen mendimet dhe sugjerimet e studentëve për lëndët dhe pedagogët, mendimet dhe sugjerimet e pedagogëve përmbarëvajtjen e lëndëve, si dhe raportimet e tyre. Evidenca: 1.14. Vendimi i Dekanatit për ngritjen e NJVSC/FSHS https://forms.gle/DJQGGY2luxkK2v226; 1.13. Manuali i vlerësimit të performancës të personelit akademik të Universitetit të Tiranës, 2018. https://unitir.edu.al/vendime-te-senatit-akademik/-
Konkluzione	UT/FSHS/DPPS ka ngritur Njësine për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe me aktet rregullatore institucionale, duke siguruar një sistem të brendshëm për sigurimin e cilësisë. UT/FSHS është nënshtruar akreditimit Institucional, duke arritur një rezultat pozitiv. UT/FSHS/DPPS përdor tregues të matshëm në

	<i>mësimdhënie dhe kërkim, për të pasqyruar gjendjen, arritjet dhe dobësitë, siç janë parashikuar në aktet rregullatore institucionale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	UT/FSHS, përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. Nga mbledhjet e dekanatit përcillen udhëzime në lidhje me zhvillimin e mësimi, problematikat e ndryshme që mund të hasen, diskutohen raste specifike, dhe më pas përgjegjësi përkatës i departamentit e ndjek rastin. Nga departamenti bëhen raportime lidhur me ecurinë e procesit në strukturat dhe autoritetet akademike e administrative. Disa nga mekanizmat apo proceset që përdoren në UT për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e vijueshëm të programeve të studimit janë: - Raportet vjetore të veprimtarisë institucionale të cilat përmbledhin analizën e procesit mësimor me të gjithë komponentët e tij; - Raporti e analizës së kërkimit me të gjithë komponentët e vlerësimit të tij. Departamenti propozon mbi ndryshimet e mundshme të programit mësimor dhe i përcjell më tej në Senatin Akademik për miratim dhe sipas rastit (nëse ishin ndryshime më pak se 20% apo më shumë se 20%) është njoftuar ministria, ose është përcjellë për marrjen e miratimit prej saj. Propozimi për hapjen e programeve të studimit apo riorganizimin e tyre vjen nga njësitë bazë që ofrojnë apo do të ofrojnë programin e

	studimit. Rezultatet e vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve vendimmarrëse sipas rastit. Evidenca: <i>1.17. Raporti periodik i NJSBC (ose raportvjetor i NJSBC)</i> <i>2.15. Të dhëna tabelore për njësinë, individët, studentët e angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel FSHS.</i> <i>2.17. Raporti periodik i NJSBC (ose raport vjetor i NJSBC)</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Raportet e vlerësimit përfshijnë të gjithë elementët e kërkuar sipas këtij kriteri, duke përmblodhur rezultatet e pritshme, analizën e vlerësimeve, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, si dhe masat e ndërmarra për përmirësimin e cilësisë dhe adresimin e mangësive. Gjithashtu, ato theksojnë nxitjen e ekselencës në mësimdhënie dhe kërkim shkencor nga stafi akademik dhe studentët. Raporti i rezultateve të pyetësorëve dhe rekomandimet e hartuara nga DKSC u përcillen Njësie Kryesore, të cilat organizojnë konsultime të zgjeruara në departamente me stafin akademik. Ky proces siguron një përmirësim transparent dhe gjithëpërfshirës të programeve të studimit përmes analizës së përgjigjeve të studentëve. Më pas, Njësitë Kryesore/Bazë shqyrtojnë rezultatet përkatëse dhe propozojnë masat e nevojshme, të cilat diskutohen në mbledhjen e Rektoratit. Evidenca: <i>3.18 Raport mbi veprimtarinë e programit të studimit për vitin akademik</i> <i>2.17 Raporti periodik ose vjetor i NJSBC</i> <i>2.16 Analiza vjetore e punës së Fakultetit të Shkencave Sociale</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në	UT/FSHS përdor një sërë metodash të drejtpërdrejta për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, përfshirë vlerësimin e didaktikës, kurrikulës dhe të procesit të të mësuarit. Këto përfshijnë gjithashtu vlerësime paralele të provimeve dhe detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë ushtrimeve dhe praktikave, si dhe testime lokale ose të standardizuara. Në programin e studimit të ciklit të dytë “Master Shkencor në Administrimin e Shërbimeve Sociale”, për vlerësimin e cilësisë dhe mbarëvajtjes së programit janë aplikuar metoda të drejtpërdrejta, duke përfshirë: vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, analizën e

auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	didaktikës, përmbajtjes kurrikulare dhe të mësuarit, si dhe vëzhgime gjatë zhvillimit të praktikave në institucione. Në fillim të vitit akademik, Përgjegjësi i Departamentit kryen kontrollin dhe vlerësimin e përmbajtjes së kurrikulave, syllabuseve dhe dokumenteve përkatëse. Për të siguruar cilësinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimit, përdoren këto procese vlerësimi: - Vlerësimi i studentëve nëpërmjet formularëve të plotësuar në fund të çdo semestri nga KPSSC; - Mbledhje mujore në Departament për monitorimin e procesit mësimor; - Raportime përmbledhëse nga drejtuesi i njësisë bazë mbi ecurinë mujore të programit të studimit; - Miratimi i tezës së provimit nga drejtuesi i Departamentit. Evidenca: <i>1.2. Statuti i UT-së;</i> <i>1.3. Rregullore e Përgjithshme e UT-së, shoqëruar me nenet përkatëse;</i> <i>3.5. Strategji e zhvillimit të programit</i> <i>3.3. Rregullore e njësisë kryesore;</i> <i>3.6. Rregullorja e programit të studimeve;</i> <i>1.11. Manuali dhe Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë e UT-së dhe Paketa e Instrumentave të Cilësisë;</i> <i>3.18. Raportet vjetore të DPP;</i> <i>2.9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i>
Kriteri 4.Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin	Universiteti i Tiranës, DPPS, përdorin edhe metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si mw poshtw: • studimi i tregut të punës • Monitorim të procesit të mësimdhënies • Vlerësim nga studentët për çdo lëndë • Formularë vlerësimi / Pyetësorë • Fokus - Grupe • Rezultatet e studentëve në provime • Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (detyra kursi, projekte, punë individuale, punë në grup) • Ndjekje, asistim dhe vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës Rezultate të punimit të diplomave

e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	DPPS është ka iniciuar ndërmarrjen e një studimi, duke fokusuar studentët e diplomuar në Masterin Shkencor ASHS, mbështetur edhe në Urdhrin e Punonjësit Social, për të matur kërkesën dhe ofertën në tregun e punës në këto drejtime kyçe, të përcaktuara dhe aplikuar direkt në tregun e punës kryesisht në sektorin publik, por jo vetëm, sikurse edhe për të krijuar Memorjen Alumni në MSHASHS/DPPS/FSHS/UT. Një nga problemet e ndeshura është marrja e informacionit për ALUMNI. Bashkëpunimi më i ngushtë me Urdhrin e Punonjësit Social, do të mundësojë një bankë të sigurtë të dhënash, të specifikuara statistikiisht dhe të mundshme për t'u përpunuar lehtësisht, për numrin e të diplomuarve të punësuar, tipologjinë e punësimit, nivelin e kualifikimeve në vijim, sikurse edhe rastet e profesionistëve më të suksesshëm. Organizimi i takimeve me bashkëpunëtorë, ekspertë të jashtëm dhe Alumni është praktikë vijuese në FSHS/DPPS Pedagogët e jashtëm që janë edhe ekspertë të fushës gjithashtu raportojnë për ecurinë e procesit mësimor dhe ofrojnë ekspertizën e tyre në përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. Evidenca: 1.2. Statuti i UT-së; 1.3. Rregullore e Përgjithshme e UT-së, shoqëruar me nenet përkatëse; 3.5. Strategji e zhvillimit të programit https://ëëë.unitir.edu.al/images/Vendimi_i_SA_nr._4_date_22.02.18.pdf 4.9. Të dhëna përmbledhëse për punësimin real të studentëve të programit https://ëëë.unitir.edu.al/Studimi_i_tregut_te_punes_final-10 Maj, 2018 .pdf 2.22. Rregullore e Zyrës së Këshillimit për Karrierrë)
Konkluzione	UT/FSHS, përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Raportet e vlerësimit përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe propozojnë masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, Për vlerësimin e mbarëvajtjes së cilësisë së programeve të studimit përdoren procese si: si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të

	provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, etj. UT/FSHS kanë aplikuar metoda. Të ndryshme të vlerësimit të cilësisë së prograit të studimit si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (ë), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	UT/FSHS siguron përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në procesin e sigurimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programit. Ekipi i vlerësimit të brendshëm përfshin gjithashtu një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve, duke garantuar një qasje gjithëpërfshirëse. Struktura e ekipit të vlerësimit të brendshëm siguron përfaqësim të plotë të të gjitha njësive akademike, duke mundësuar një vlerësim gjithëpërfshirës dhe të balancuar. Evidenca: 1.2. Statuti i Universiteti i Tiranës, 1.7. Rregullore mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ në Universitetin e Tiranës; 1.4. Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023, 2.14. Informacion për politikën e zhvillimit dhe përmirësimit të kurrikulave; 2.20. Politika e FSHS për zhvillimin profesional të personelit akademik; 2.14. Politika e FSHS e publikimit të informacionit të sigurimit të cilësisë, informacioneve për programet e studimit; 2.13. Rregullore e NJSC të FSHS; 1.2. Statutii UT-së;

	<i>1.3. Rregullore e Përgjithshme e UT-së;</i> <i>3.5.Strategji e zhvillimit të programit;</i> <i>3.3. Rregullore e njësisë kryesore;</i> <i>3.6. Rregullorja e programit të studimeve).</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	UT/FSHS ka përcaktuar përgjegjësi dhe detyra specifike për njësitë, individët, studentët dhe palët e tjera të përfshira në sigurimin e brendshëm të cilësisë për programin e studimit Master Shkencor në Administrimin e Shërbimeve Sociale. Ky proces përfshin gjithashtu detyrat, përgjegjësitë dhe procedurat e NJVSC-së në UT/FSHS, në lidhje me këtë program. Anëtarët e Ekipit të Vlerësimit të Brendshëm dhe Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë kanë role dhe detyra specifike, të përshtatura sipas përgjegjësi të tyre, duke siguruar një qasje të strukturuar dhe efektive në procesin e vlerësimit. Evidenca: <i>1.2. Statuti i UT-së;</i> <i>1.3.Rregullore e Përgjithshme e UT-së;</i> <i>3.5.Strategji e zhvillimit të programit;</i> <i>3.3. Rregullore e njësisë kryesore;</i> <i>3.6. Rregullorja e programit të studimeve</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Në procesin e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit janë përfshirë anëtarë të stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ të njësisë bazë DPPS dhe FSHS, si dhe studentët e programit. Për këtë qëllim, në nivel fakulteti është krijuar Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili përfshin jo vetëm stafin akademik të brendshëm, por edhe një përfaqësues studentor. Një tjetër tregues i përfshirjes aktive të studentëve është pyetësori i organizuar nga NJVSBC në fund të çdo semestri, i cili shërben për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies për secilën lëndë. Evidenca: <i>1.2. Statuti i UT-së;</i> <i>1.3. Rregullore e Përgjithshme e UT-së;</i> <i>3.5. Strategji e zhvillimit të programit;</i> <i>3.3. Rregullore e njësisë kryesore;</i>

Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	3.6. Rregullorja e programit të studimeve Gjatë implementimit të instrumenteve të drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë nga strukturat përkatëse, me qëllim vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit, është garantuar respektimi i lirisë dhe etikës akademike, në përputhje me Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, i ndryshuar me Ligjin Nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe i reflektuar në dokumentet bazë të UT-së. Vlerësimi i cilësisë së programit të studimit kryhet nga studentët e çdo kursi në mënyrë anonime, duke garantuar konfidencialitetin e tyre. Deri më tani, nuk është raportuar asnjë rast i ankesave për diskriminim apo pabarazi. <i>Megjithatë, mungesa e raporteve analitike ndër vite kufizon burimet e informacionit, ndaj vlerësimi mbështetet kryesisht në procedurat administrative të dokumentuara në aktet themelore të UT-së.</i> Përfshirja dhe angazhimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit është në përputhje me Kodin e Etikës, duke synuar shmangien e çdo lloj diskriminimi apo trajtimi të pabarabartë ndaj personelit dhe studentëve. Personeli akademik i përfshirë në vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit nuk ushtron funksione drejtuese brenda institucionit dhe përfaqëson figura me integritet profesional në njësinë bazë. Gjithashtu, pjesëmarrja e studentëve të programit Master i Shkencave në ASHS në këtë proces siguron një qasje gjithëpërfshirëse dhe ndihmon në respektimin e integritetit dhe barazisë në raport me personelin akademik dhe studentët. Evidenca: 1.2. Statuti i UT-së; 1.3. Rregullore e Përgjithshme e UT-së; 3.3. Rregullore e njësisë kryesore; 3.6. Rregullorja e programit të studimeve; 1.8. https://unitir.edu.al/ep-content/uploads/2019/12/Rregullorja_mbrojtjen2.pdf Rregullore për “Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale në Universitetin e Tiranës” 1.4. Paketa e instrumenteve të cilësisë
---	--



	<i>Vendim Nr. 6 datë 11.02.2020 për miratimin e rregullores për konfliktin e interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Universitetin e Tiranës; 1.5. Kodi Etikës së UT).</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Drejtorja e Kurrikulës dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, së bashku me sektorët përkatës, KPVBC, si dhe Njësia Bazë FSHS dhe NJVSBC, kanë bashkëpunuar ngushtë për të mbledhur informacion gjithëpërfshirës dhe për të identifikuar instrumentet më të përshtatshme që ndihmojnë në kapërcimin e sfidave. Qëllimi i këtij procesi është përmirësimi i cilësisë akademike dhe sigurimi i shërbimeve më të mira për studentët në kuadër të programit Master Shkencor “Administrim i Shërbimeve Sociale”. Për këtë arsye, është zhvilluar një bashkëpunim i vazhdueshëm me ekspertë dhe bashkëpunëtorë të jashtëm për të rritur standardet e programit të studimit. Përbërja e GVB përfshin vetëm anëtarë të brendshëm të departamentit dhe studentë, duke mos pasur përfaqësues aktivë nga fusha e shërbimeve sociale. Megjithatë, në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë marrin pjesë edhe bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm, si pedagogë me kohë të pjesshme, përfaqësues të institucioneve partnere dhe ish-studentë (alumni). Ekspertiza dhe mendimet e tyre kontribuojnë në përmirësimin e programit përmes tryezave të rumbullakëta, aktiviteteve të përbashkëta, mbledhjeve dhe diskutimeve profesionale. Evidenca: 1.2. Statuti i UT-së; 1.3. Rregullore e Përgjithshme e UT-së; 3.5. Strategji e zhvillimit të programit).
Konkluzione	<i>Institucioni garanton përfshirje të aktorëve të brendshëm dhe jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit duke përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë, individët, studentët dhe pale të tjera, të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. Në procesin e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit janë përfshirë anëtarë të stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ të njësisë bazë DPPS dhe FSHS, si dhe studentët e programit. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit është në përputhje me Kodin e Etikës dhe përpiqet të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe të drejtave</i>

	të studentëve. Përbërja e GVB përfshin vetëm anëtarë të brendshëm të departamentit dhe studentë, duke mos pasur përfaqësues aktivë nga fusha e shërbimeve sociale			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politikat, strategjitë, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë bërë transparente dhe publike nga Universiteti i Tiranës dhe FSHS, duke u vënë në dispozicion të studentëve dhe të gjithë palëve të interesuara. Në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, për të gjitha programet e studimit, informacioni i rëndësishëm është bërë publik përmes postimit në faqen zyrtare elektronike të Universitetit, ku përfshihen: • Statuti i UT, • Vendimet e Senatit Akademik, • Vendimet e Bordit të Administrimit, • Raportet e analizës së rezultateve të pyetësorëve të studentëve, • Aktivitetet e organizuara për përmirësimin e cilësisë, etj. Gjithashtu, informacioni shpërndahet edhe përmes shkresave zyrtare drejtuar Njërive Kryesore dhe Njërive Bazë. Analizat pas vlerësimit duhet të përdoren për përmirësimin e arkitekturës së shërbimeve, duke synuar rritjen e cilësisë së brendshme jo vetëm për programin Master Shkencor "Administrim i Shërbimeve Sociale", por edhe për DPPS, FSHS dhe UT në tërësi. Evidenca: <i>1.2. Statutii UT-së;</i> <i>1.3. Rregullore e Përgjithshme e UT-së;</i> <i>3.5. Strategji e zhvillimit të programit;</i> <i>3.3. Rregullore e njësisë kryesore).</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon	Universiteti i Tiranës/FSHS ka publikuar rezultatet e vlerësimeve të programeve të studimit, duke ruajtur lirinë dhe etikën akademike, si

rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	dhe duke siguruar mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me legjislacionin aktual. Në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 531, datë 11.09.2018, "Për Miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë", ky standard realizohet përmes raporteve të analizës së pyetësorëve të studentëve mbi cilësinë e mësimdhënies për çdo lëndë dhe program studimi. Informacioni i publikuar në këto raporte është në përputhje me parimet e konfidencialitetit dhe etikës akademike, duke respektuar Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, të ndryshuar me Ligjin Nr. 48/2012 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale". Të gjitha raportet e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit janë të disponueshme në faqen zyrtare të internetit të FSHS, e cila është në proces përditësimi. Evidenca: <i>1.2. Statuti i UT-së;</i> <i>1.3. Rregullore e Përgjithshme e UT-së;</i> <i>3.5. Strategji e zhvillimit të programit;</i> <i>2.14. Politika e FSHS e publikimit të informacionit të sigurimit të cilësisë, informacioneve për programet e studimit;</i> <i>2.17. Raporti periodik i NJSBC (ose raport vjetor i NJSBC);</i> <i>1.18. Rregullore e UT-së për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjes dhe sigurisë e të dhënave personale në UT</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Pas Analizës dhe Vlerësimit të Pyetësorëve të Studentëve për Cilësinë e Mësimdhënies për Lëndët e çdo Programi Studimi në Universitetin e Tiranës, NJSBC, përpos Raportit të Analizës përpilon dhe projekt propozimet dhe rekomandimet për përmirësimin e cilësisë, duke e përcjellë më tej, pranë strukturave përkatese të parashikuara në procedurën e analizës së pyetësorëve. Në përfundim të zbatimit të gjithë fazave të parashikuara në procedurën e sipërcituar, përpilohet Plani i Masave për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në Programet e Studimit dhe Mësimdhënien, i cili përcillet për miratim pranë Senatit Akademik të institucionit. Pas miratimit prej këtij të fundit, Plani i Masave, publikohet në faqen UT-së, FSHS-së dhe monitorohet zbatimi i tij, prej Zv Rektorit, DKSC, Dekanëve dhe NJVSB. Evidenca: <i>1.2. Statuti i UT-së;</i> <i>1.3. Rregullore e Përgjithshme e UT-së</i>



Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Programet e studimit përmirësohen vazhdimisht përmes pasurimit të literaturës bazë dhe mbështetëse, përditësimit të materialeve dhe temave mësimore, si dhe përmes ndryshimeve profilizuese të programit të studimit deri në masën 20%, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Si rregull, ndryshime të tilla mund të realizohen vetëm një herë nga një akreditim në tjetrin, megjithatë mund të ketë përjashtime të justifikuara. Akreditimi është një proces i rëndësishëm dhe luan një rol të madh në marrjen e vendimeve për ndryshime profilizuese të programit të studimit, për arsyet e mëposhtme: - Vlerësimi i jashtëm i programit të studimit nga ekspertë dhe rekomandimet e tyre mund të nxjerrin në pah nevojën për përmirësime të programit. - Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit gjithashtu ndihmon në identifikimin e pikave të forta dhe të dobëta të tij. - Akreditimi i programit realizohet pas një periudhe të caktuar kohe, kur mësimdhënia është konsoliduar, rezultatet e studentëve janë vlerësuar disa herë dhe nevojat për përmirësime janë më të bazuara. Evidenca: 1.2 Statuti i UT-së; 1.3.Rregullore e Përgjithshme e UT-së, 3.5.Strategji e zhvillimit të programit;)
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	UT FSHS ka organizuar aktivitete dhe seminare informuese me studentët, kryesisht në formën e fushatave ndërgjegjësuere për rëndësinë e pjesëmarrjes vullnetariste në përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit dhe shërbimeve administrative që ata marrin. Këto aktivitete përfshijnë: • Takime direkte me studentët në auditorë; • Publikim njoftimesh në rrjetet promovuese online të Universitetit; • Publikim njoftimesh në llogaritë personale në Sistemin e Informacionit të UT-së dhe platformat online; • Programet e shkëmbimit në kuadër të projekteve ndërkombëtarë; Ekipi i Vlerësimit të Brendshëm organizon aktivitete periodike me personelin dhe studentët për informimin, ndërgjegjësimin dhe trajnimin e tyre. Në vitin akademik 2019-2020, këto aktivitete u

	realizuan gjithashtu online për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19. Përmes aktiviteteve si java e orientimit dhe sesioneve trajnimi që realizohen në fillim të çdo viti akademik, studentët dhe stafi akademik informohen dhe ndërgjegjësohen mbi rëndësinë e vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit të programeve të studimit.			
Konkluzione	<i>Politika, strategji, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit Master SHkencor ne ASHS janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. Rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, publikohen nga UT/FSHS, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale si dhe shoqërohen me nje plan masash konkrete. UT/FSHS dhe DPPS vlerësojnë dhe sigurojnë efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. UT/FSHS dhe DPPS kanë organizuar veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave
“Master i Shkencave në Adminstrim i Shërbimeve Sociale” ofruar nga Institucioni i Arsimit
të Lartë “Universiteti i Tiranës”**

Pikat e forta dhe afirmime

1. Lidhje të forta dhe bashkëpunim shumë i mirë me tregun e punës.
2. Personel akademik i kualifikuar, në përputhje me profilin dhe objektivat e programit dhe i pajisur me grada dhe tituj shkencorë.
3. Infrastrukturë mjaft e përshtatshme dhe e pajisur me teknologjinë e duhur për mësimdhënie.
4. Përfshirja në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe përfshirja e studentëve në projektet e kërkimit shkencor.
5. Qëndrueshmëria në numrin e studentëve, pavarësisht trendit rënës në rrafsh kombëtar.

Pika të dobta

1. Përputhshmëria e programit të studimit me aktet nënligjore në fuqi (VKM 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar). *(Standard II.1, Kriteri 1)*
2. Përdorimi i literaturës së vjetëruar në këtë program studimit. *(Standard IV.3, Kriteri 2)*
3. Mungesa e lidhjeve sistematike me studentët dhe institucionet partnere në lidhje me përmirësimet kurrikulare. *(Standard I.1, Kriteri 5)*
4. Përfshirja e ulët studentëve në mobilitete (Erasmus+). *(Standard II.7, Kriteri 4)*

Rekomandime

1. GVJ rekomandon përshtatjen e programit të studimit me aktet nënligjore në fuqi.
2. Ngritja e një laboratorit të teknologjisë së informacionit në rang fakulteti.
3. Rekomandon organizimi i takimeve të institucionalizuara me student dhe përfaqësues të institucioneve partnere me qëllim përditësimet kurrikulare në funksion të punësimit të studentëve të diplomuar.
4. Përditësimi i kurrikulës me lëndë nga vendet e BE-OECD si dhe azhurnimin e literaturës, me qëllim përditësimin e studentëve me kërkesat ndërkombëtare të tregut të punës.
5. Përfshirje më e madhe e studentëve në mobilitetet Erasmus+
6. GVJ rekomandon kujdes të shtuar në pajisjen me dokumentacionin e duhur duke qenë se në disa raste nuk mori informacionin e duhur.
7. Rekomandohet hartimi i një manuali të veçantë në departament në lidhje me format e mësimdhënies, të pasuruar nga përvojat dhe propozimet e stafit akademik, si dhe nga propozimet e studentëve.
8. Rekomandohet blerja dhe aplikimi i programeve antiplagjiaturë në detyrat e kursit dhe në punimet e diplomave.

Conclusions of the Evaluation of the second cycle study program Master of Science in “Social Services Administration” offered by the Higher Education Institution “University of Tirana”

Strengths and affirmations

1. Strong connections and very good cooperation with the labor market.
2. Qualified academic staff, in line with the profile and objectives of the program and equipped with scientific degrees and titles.
3. Quite suitable infrastructure and equipped with the appropriate technology for teaching.
4. Involvement in national and international projects, and the involvement of students in scientific research projects.
5. Stability in the number of students, despite the downward trend at the national level.

Weaknesses

1. Compliance of the study program with the applicable sub-legal acts (DCM 41, dated 24.01.2018, as amended). *(Standard II.1, Criterion 1)*
2. Outdated literature used in this study program. *(Standard IV.3, Criterion 2)*
3. Lack of systematic connections with students and partner institutions regarding curricular improvements. *(Standard I.1, Criterion 5)*
4. Very low involvement of students in mobility (Erasmus+). *(Standard II.7, Criterion 4)*

Recommendation

1. EEG recommends adapting the study program to the applicable by-laws.
2. Establishing an information technology laboratory at the faculty level.
3. EEG recommends organizing institutionalized meetings with students and representatives of partner institutions with the aim of curricular updates in order to employ graduate students.
4. It is recommended updating the curriculum with subjects from EU-OECD countries and updating the literature, in order to update students with international labor market requirements.
5. It is recommended a greater involvement of students in Erasmus+ mobilities
6. EEG recommends increased care in providing the appropriate documentation, given that in some cases the appropriate information was not received.
7. EEG Recommends drafting a special manual in the department regarding teaching formats, enriched by the experiences and proposals of academic staff, as well as by student proposals.
8. It is recommended to purchase and apply anti-plagiarism programs to course assignments and diploma theses.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

